Funded by the European Union

EU4 Good Governance

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
INFORMATION AND DATA PROTECTION COMMISSIONER

KOMENTAR
MBI
KUPTIMIN DHE ZBATIMIN E LIGJIT PËR TË DHËNAT E HAPURA DHE RIPËRDORIMIN E INFORMACIONIT NË SEKTORIN PUBLIK

A. HYRJE 3
I. QËLLIMI I KOMENTARIT 3
II. METODOLOGJIA PËR HARTIMIN E KOMENTARIT 4
B. QËLLIMI I LIGJIT DHE LIDHJA ME LEGJISLACIONIN NË FUQI PËR TRANSPARENCËN 4
I. TË DHËNAT E HAPURA, RIPËRDORIMI PËRKUNDREJT MEKANIZMAVE TË TJERË TË TRANSPARENCËS 7
II. KOMPETENCAT E KOMISIONERIT 12
C. KONCEPTET KRYESORE TË LIGJIT 13
I. PËRKUFIZIMET 13
1. Formati i lexueshëm nga kompjuteri 13
2. Të dhënat e hapura (Open data) 14
3. Ripërdorimi 18
4. Të dhënat kërkimore 20
5. Të dhënat dinamike 20
6. Të dhënat me vlerë të madhe 21
7. Metadata 23
II. MARRËVESHJET EKSKLUZIVE 23
III. HARTËZIMI I ORGANEVE TË SEKTORIT PUBLIK/SIPËRMARRJEVE PUBLIKE 24
IV. KUFIZIMET NË ZBATIMIN E LIGJIT 27
D. DETYRIMET E SEKTORIT PUBLIK PËR DHËNAT E HAPURA 29
I. KU I GJEJMË TË DHËNAT E HAPURA? 29
II. HARTIMI I LISTËS 29
III. DETYRIMI PËR PUBLIKIM/PËRDITËSIM 34
IV. FORMATET/LICENCA 36
V. TARIFA 41
E. E DREJTA PËR RIPËRDORIM 42
I. KËRKESA DREJTUAR ORGANIT 43
II. ARSYET E REFUZIMIT 45
III. ANKESA 47
Rastet e Vendimmarrjes së Komisionerit 48
Ë. MBIKËQYRJA E ORGANEVE TË SEKTORIT PUBLIK DHE SIPËRMARRJEVE PUBLIKE 49
I. PARIMET 49
II. PROCEDURA E MBIKËQYRJES 49
ANEKSET 58

A. HYRJE

I. QËLLIMI I KOMENTARIT

Ky komentar është hartuar me qëllim të lehtësimit të zbatimit të Ligjit nr. 33, datë 31.03.2022, "*Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik*" (në vijim "*Ligji nr.33/2022*"), i cili transposon Direktivën e Bashkimit Evropian me të njëjtin titull[1].

Sasia dhe shumëllojshmëria e të dhënave publike në vendin tonë është rritur ndjeshëm në vitet e fundit. Pavarësisht nga fakti se shumë organe të sektorit publik kanë shpenzuar shuma të mëdha parash në infrastrukturën e tyre të të dhënave, informacioni/të dhënat mbeten ende të mbyllura për publikun e gjerë, dhe të aksesueshme vetëm nga ekspertët/stafet e tyre. Organet e sektorit publik kanë ndjekur një qasje konservatore duke mbajtur të dhënat e tyre brenda institucionit, pasi sipas tyre vënia në dispozicion e ekspozon atë ndaj rrezikut të keqpërdorimit ose keqinterpretimit.

Në epokën digjitale, hapja e të dhëna është kthyer në detyrim ligjor dhe prandaj të gjithë aktorët e përfshirë duhet të kuptojnë drejt vlerën dhe rëndësinë e të dhënave të hapura dhe të angazhohen për t'i bërë ato të disponueshme. Në realitetin vendas, fuqinë apo potencialin e informacionit/të dhënave e kemi kuptuar dhe vazhdojmë ta kuptojmë në funksion të transparencës në qeverisje dhe lehtësimit të pjesëmarrjes së qytetarëve në të. Por me avancimin galopant të teknologjisë dhe digjitalizimit edhe kuptimi i deritanishëm mbi fuqinë/potencialin e të dhënave ka ndryshuar, duke shkuar përtej kërkesës për transparencë në qeverisje. Nëpërmjet miratimit të Ligjit nr.33/2022 nuk u përmbush vetëm detyrimi për harmonizimin dhe përafrimin e legjislacionit në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE, por u krijuan premisat bazë për të zbatuar edhe anën tjetër të rëndësisë së informacionit/të dhënave, atë të një motori për inovacionin, krijimin e vendeve të punës dhe gjenerimin e mirëqënies si e mirë publike.

Nisur nga kjo premisë, Komentari shërben si një udhëzues praktik për të gjithë organet e sektorit publik ose sipërmarrjet publike për të lehtësuar kuptimin dhe interpretimin e koncepteve të reja që ky ligj prezanton, shpjeguar mënyrën se si do të përmbushen detyrimet ligjore në lidhje me të dhënat e hapura dhe ripërdorimin, si dhe mekanizmat që do të përdoren për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtës për ripërdorim.

[1] Kjo Direktivë ka hyrë në fuqi në datën 16 Korrik 2019 dhe njihet gjithashtu edhe si "Open Data Directive". Directive (EU) 2019/1024 of the European Parliament and of the Council of 20 June 2019 on open data and the re-use of public sector information (recast).
https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?qid=1561563110433&uri=CELEX:32019L1024

Mbështetur në trajtimin teorik të rregullave të zbatueshme për të dhënat e hapura si dhe në praktikat e mira nga vende të ndryshme të BE-së që kanë fituar eksperiencë me të dhënat e hapura, Komentari synon të sqarojë dhe saktësojë në mënyrë të unifikuar, kuptimin e drejtë të ligjit dhe mekanizmave që kontribojnë në zbatimin e qasje së qeverisjes së hapur.

Komentari synon t'u vijë në ndihmë, më së pari, punonjësve të ngarkuar me detyrat e publikimit të të dhënave të hapura dhe ripërdorimin e dokumenteve, si dhe çdo aktori tjetër (biznes, shoqëri civile, gazetar, qyetar) të përfshirë drejtëpërdrejtë apo tërthorazi në këtë proces, të njohin më mirë rregullat e zbatueshme në situata konkrete të ndryshme, me synimin final të krijimit të një sistemi funksional të të dhënave të hapura dhe ripërdorimit të tyre në funksion të nxitjes së inovacionit në ofrimin e produkteve dhe të shërbimeve.

II. METODOLOGJIA PËR HARTIMIN E KOMENTARIT

Komentari është hartuar bazuar në një qasje transparente dhe gjithëpërfshirëse që gërsheton elementë të kërkimit dhe studimeve të thelluara, diskutimeve me përfaqësues të institucioneve homologe, si dhe diskutime konsultuese me përfaqësues të organeve të sektorit publik, sipërmarrjeve publike, SME, start-ups, etj. Ky komentar është hartuar në bashkëpunim me ekspertët e projektit të Bashkimit Evropian "EU4GoodGovernance" dhe pjesë e procesit të punës ka qenë edhe shkëmbimi i frytshëm i këndvështrimeve me profesionistë të fushës nga vende të rajonit si Mali i Zi që tashmë kanë një eksperiencë të konsoliduar në fushën e të dhënave të hapura.

Draft Komentari iu nënshtrua një procesi konsultativ të brendshëm me stafin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijm *"Zyra e Komisionerit"*) me qëllim hartimin e një qasjeje të unifikuar të zbatimit të këtij ligji me atë të të drejtës së informimit. Gjithashtu, aspekte të Komentarit u diskutuan edhe në një event publik me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të organeve të ndryshme publike dhe sipërmarrjeve publike. Çështjet e evidentuara gjatë diskutimeve u përfshinë në Komentar me qëllimin, sqarimin e çdo aspekti që merr rëndësi në zbatim të Ligjit nr.33/2022.

B. QËLLIMI I LIGJIT DHE LIDHJA ME LEGJISLACIONIN NË FUQI PËR TRANSPARENCËN

Ligji nr.33/2022 është një tjetër akt që i shtohet tërësisë së ligjeve që rregullojnë transparencën dhe mirëqeverisjen. Duke qenë se ky ligj transpozon pothuajse tërësisht Direktivën e BE-së për Opendata, qëllimi i tij përputhet plotësisht me atë të kësaj Direktive. Ky ligj krijon premisat ligjore për nxitjen e ekonomisë së të dhënave (ose atë që bazohet në të dhëna). Në themel të tij qëndrojnë

dy parime kryesore: transparenca dhe konkurenca e ndershme. Organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike janë krijuesit dhe ruajtësit më të mëdhenj të të dhënave/informacionit.

Parashikimet e Ligjit nr.33/2022 janë në thelb, sa një instrument ligjor, ashtu edhe ekonomik për ti bërë të disponueshme sa më shumë të dhënat e hapura për ripërdorim. Vetë Direktiva parashikon se ajo përmban nivelin minimal të rregullimit[2] duke i lënë hapësirë legjislatorit vendas të zgjerojë zbatimin dhe efektet e detyrueshme. Në thelb të ligjit (dhe Direktivës) qëndron parimi *"open by default"* për të dhënat/informacionin që kanë prodhuar dhe ruajnë organet e sektorit publik, sipërmarrjet publike dhe të dhënat nga kërkimet shkencore të financuara me fonde publike.

Kuadri ligjor në fushën e të drejtës për informim përbëhet nga:

- Ligji nr. 119/2014 *"Për të drejtën e informimit",* i ndryshuar, që rregullon të drejtën e njohjes me informacionin publik që prodhohet apo mbahet nga autoritetet publike.
- Ligji nr.146/2014 "*Për njoftimin dhe konsultimin publik*", që rregullon mënyrën, formën dhe afate për konsultimin e projektligjeve, projektdokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik.
- Ligji nr. 45/2022 "*Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për aksesin në dokumentet zyrtare*", (Konventa Tromso), e cila garanton zbatimin e standardeve më të larta ndërkombëtare për aksesin e qytetarëve në informacionin që prodhojnë/ruajnë autoritetet publike.

Kuadri ligjor në fushën e të dhënave personale përbëhet nga:

- Ligji nr.8137, datë 31.7.1996 *"Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore";*
- Ligji nr.9288, date 7.10.2004, *"Për ratifikimin e Konventes për mbrojtjen e individeve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale"*, i ndryshuar.
- Ligj nr. 49/2022 *"Për ratifikimin e protokollit ndryshues të Konventës për mbrojtjen e individëve, në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale"*
- Ligji nr.124/2024 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale".*

Neni 5 i Ligjit nr.33/2022 rregullon lidhjen dhe ndërveprimin midis këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fushën e aksesit në dokumente, të drejtës për informim, mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe pronësinë intelektuale. Sipas parashikimeve të këtij neni, ky ligj bazohet në kuadrin ekzistues ligjor që rregullon të drejtën për akses në dokumentet publike. Si i tillë, ligji nuk krijon të drejta shtesë për akses në informacion përtej atyre të parashikuara nga legjislacioni ekzistues. Në këtë mënyrë, fokusi i ligjit mbetet ripërdorimi i të dhënave dhe jo zgjerimi i të drejtave për akses.

[2] Direktiva (BE) 2019/1024, Art. 1, para. 1: "Kjo Direktivë përcakton një sërë rregullash minimale që rregullojnë ripërdorimin dhe masat praktike për lehtësimin e ripërdorimit […]"

Më tej, po e njëjta dispozitë sqaron se zbatimi i këtij ligji nuk ndikon në dispozitat e ligjit për të drejtën e informimit. E njëjta vlen edhe për detyrimet ligjore që mbrojnë konfidencialitetin e informacionit. Institucionet publike duhet të sigurojnë që zbatimi i këtij ligji të mos cënojë rregullat për ruajtjen e informacionit konfidencial. Legjislatori është kujdesur të ndajë zbatimin e këtij ligji nga ai i të drejtës për informim. Ndërkohë në disa shtete të BE-së si për shembull në Norvegji, Estoni apo Portugali, Direktiva për open data është integruar si pjesë e legjislacionit për të drejtën e informimit.

Dispozita sqaron edhe cila është marrëdhënia e këtij ligji me atë për mbrojtjen e të dhënave personale. Kështu, ky ligj nuk cenon të drejtat e individëve sa i përket përpunimit të të dhënave personale. Çdo përpunim apo shpërndarje e të dhënave duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë në komunikimet elektronike. Organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike duhet të respektojnë parashikimet e atij legjislacioni kur publikojnë të dhëna të hapura dhe vendosin mbi ripërdorimin e dokumenteve.

Më tej, po në të njëjtën dispozitë në paragrafin 4, parashikohet se ky ligj nuk ndikon në të drejtat e pronësisë intelektuale të mbrojtura nga legjislacioni për të drejtën e autorit dhe marrëveshjet ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë. Kjo do të thotë se ripërdorimi i informacionit publik duhet të kryhet në përputhje me të drejtat e autorëve dhe të drejtat e lidhura me të. Në të njëjtën kohë, ky ligj nuk prek të drejtat e pronësisë intelektuale të palëve të treta mbi krijimin e databazave. Kështu, çdo informacion i nxjerrë nga databaza të krijuara nga organe shtetërore apo sipërmarrje publike të ndryshme nuk mund të ripërdoret nëse nuk garantohet se respektohen të drejtat e autorit mbi këto databaza.

Së fundmi, dispozita saktëson në paragrafin e pestë se parashikimet në këtë ligji për ripërdorimin e dokumenteve të sektorit publik dhe sipërmarrjeve publike, zbatohen edhe për dokumentet që rregullohen nga ligji për të dhënat gjeohapësinore. Për rrjedhojë, informacionet me përmbajtje gjeohapësinore mund të ripërdoren në përputhje me rregullat e përcaktuara për qasjen dhe shpërndarjen e tyre.

I. TË DHËNAT E HAPURA, RIPËRDORIMI PËRKUNDREJT MEKANIZMAVE TË TJERË TË TRANSPARENCËS

Transparenca trajtohet nga këndvështrime të ndryshme: ajo është, sa parim ku duhet të mbështetet aktiviteti i administratës publike, aq edhe qëllim i synuar nga administrata publike; dhe pa diskutim mjeti që administrata duhet ta përdorë për realizimin e funksioneve të saj[3].

Transparenca në informacion nënkupton shpërndarjen, publikimin, vënien në dispozicion të informacionit në një mënyrë që e bën atë të aksesueshëm/disponueshëm dhe të kuptueshëm për gjithë qytetarët dhe grupet e interesit. Sipas kuadit ligjor në fuqi[4], evidentohen dy kategori/klasifikime të mëdha në lidhje me informacionet që krijojnë, prodhojnë, ruajnë dhe shpërndajnë organet e të gjitha pushteveve (legjislativ, ekzekutiv, gjyqësor). Ky klasifikim lidhet me natyrën dhe qëllimin e përdorimit të informacionit. Informacioni mund të jetë **i aksesueshëm ose i paaksesueshëm** për shkak të kufizimeve në parashikime të ndryshme ligjore (të tilla si: klasifikimi sekret shtetëror, objekt i mbrojtjes së të dhënave personale, pronësisë intelektuale, për shkak të rendit dhe sigurisë publike, apo edhe ruajtjes së konfidencialitetit etj).

Brenda kategorisë së informacionit të akesesueshëm ekzistojnë disa mjete ligjore që zbatohen në kontekstin vendas, që tashmë do të përfshijnë jo vetëm "*Programin e transparencës*" dhe mekanizmin për realizimin e të drejtës për akses në informacion, por edhe të dhënat e hapura dhe ripërdorimin. Ky kuadër rregullator, në tërësi garanton aksesin e qytetarëve në informacionin zyrtar dhe është një mundësi për pjesëmarrjen e qytetarëve në mirëqeverisje.



[3]Digjitalizimi i shërbimeve publike dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut në Shqipëri 2024, Raport i Avokatit të Popullit, fq.55
https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/03%20Raporti%20Shqip%20Digjitalizimi%20i%20sh%C3%ABrbimeve%20Pdf.pdf
[4] Neni 5 i Ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar

Ligji për të drejtën e informimit, ka si qëllim parësor të tij, dhënien e informacionit që prodhohet apo mbahet nga ana e autoriteteve publike me apo pa kërkesë, publikut, dhe realizimin e një qeverisje të hapur. Nga ana tjetër, ligji për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik i ofron mundësinë biznesit, shoqërisë civile, qytetarëve si dhë të gjithë grupeve të interesit të përdorin informacionin e sektorit publik, për një qëllim të ndryshëm nga detyra fillestare publike për të cilën është prodhuar.

Në kuadër të Programit të Transparencës[5], organet e sektorit publik mbartin detyrimin të publikojnë (pa kërkesë) këto dokumente nga ku rezulton pikëprerje me rubrikën e të dhënave të hapura si vijon:

	Programi i Transparencës	Të dhëna të Hapura	Pikëprerje/Komente
1	a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;	Nuk konsiderohet e dhënë e hapur.	
2	b) tekstet të plota të legjislacionit (nënpikat i-vi).	Nënpika *"v) çdo dokumenti politikash"* konsiderohet e dhënë e hapur. Tekstet ligjore që formësojnë kuadrin ligjor mbi të cilën operon organi apo sipërmarrja nuk klasifikohen si të dhëna të hapura.	Vetëm dokumentet e politikave konsiderohen si të dhëna të hapura. Në këtë kontekst organi duhet të publikojë jo vetëm draftin përfundimtar, por edhe projektaktet (versionet) që paraprijnë miratimin.
3	c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ushtrimit të mjeteve ligjore administrative;	Nuk konsiderohet e dhënë e hapur.	Mbetet informacion ligjor në kuadër të ushtrimit të drejtës së informimit.
4	ç) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe	Nuk konsiderohet e dhënë e hapur.	

[5] Neni 7 i Ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar

	kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;		
5	d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;	Nuk konsiderohet e dhënë e hapur	
6	dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga KLSH ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;	Planet strategjike dhe çdo dokument tjetër politikash konsiderohet e dhënë e hapur.	
7	e) të dhëna për buxhetin/planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së	Të dhënat e listuara në shkronjën e) konsiderohen të dhëna të hapura.	Kjo përbën pikëprerje midis dy mekanizmave Për rrjedhojë organi ose sipërmarrja duhet të vendosë të dhënat në rubrikën open data.

	detyrimeve nga subjektet e licencuara;		
8	ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020, dhe të Ligjit nr. të ndryshuar, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;	Të dhënat e listuara në shkronjën ë) konsiderohen të dhëna të hapura.	Midis dy mekanizimave konstatohen pikëprerje. Por natyra e të dhënës që publikohet në open data *(psh. të dhëna statistikore)* ndryshon nga ajo tek Programi i Transparencës.
9	f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;	Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me të dhënë të hapur.	
10	g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik	Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me të dhënë të hapur.	
11	gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo	Nuk konsiderohet e dhënë e hapur.	

	ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;		
12	h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;	Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me të dhënë të hapur.	
13	i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji;	Në këtë rast kemi të bëjmë me të dhënë të hapur.	
14	j) një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato;	Kjo është e dhënë e hapur.	Në këtë rast në rubrikën të dhëna të hapura nuk mund të vendosen emrat e përfituesve, por të dhëna të tjera që lidhen me skemën, vlerën totale, numrin e përfituesve etj.
15	k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh;	Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me të dhënë të hapur.	
16	l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik.	Në këtë rast kemi të bëjmë me të dhënë të hapur.	

Edhe pse në pamje të parë objekti dhe qëllimi i ligjeve të sipërcituara mund të duket i njëjti, tabela e mësipërme tregon që ka pikëprerje dhe njëkohësisht një tension natyral midis tyre. Koncepti i të dhënave të hapura është zhvilluar nga e drejta për informim mbi informacionin e mbajtur nga autoritetet publike, për të garantuar transparencë në qeverisje dhe llogaridhënie, si dhe për të krijuar besimin e publikut, dhe nëpërmjet kësaj, zgjeruar pjesëmarrjen e publikut.[6] E drejta e informimit është parakusht për të kuptuar të dhënat e hapura dhe ripërdorimin.

[6] Worthy, B. (2010). More open but not more trusted? The effect of the Freedom of Information Act 2000 on the United Kingdom central government. Governance, 23(4), 561-582.

Në analizë të mekanizimave të lartpërmendur rezulton që jo çdo dokument që sipas ligjit mund të vihet në dispozicion nëpërmjet mekanizimit të të drejtës së informimit, mund të klasifikohet automatikisht si e dhënë e hapur dhe për rrjedhojë edhe për ripërdorim. POR çdo e dhënë e hapur mund të jetë e njëjtë me atë që mund të vihet në dispozicion nëpërmjet mekanizimit të të drejtës së informimit.

Shembull: Referuar praktikave të krijuara nga vendet e tjera, duke përfshirë ato të rajonit rezulton se në kontekstin e prokurimit publik të dhëna të hapura do të konsiderohen:

- *plani për prokurimet publik;*
- *raporti i prokurimeve publike të realizuara;*
- *kontratat e prokurimit publik janë publikuar.*

Deri përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr.33/2022, kontrata e prokurimit për një shërbim/produkt të caktuar kërkohej nëpërmjet mekanizimit të ligjit të të drejtës së informimit. Nëpërmjet të dhënave të hapura, do të jetë e mundur të aksesohet plani i prokurimit publik, raporti i prokurimeve publike të realizuara dhe kontratat e prokurimit në vlerë totale (pra të dhënat e kontratës si vlerë dhe jo kontratat si veprim juridik).
Prandaj, kontrata e prokurimit për një shërbim/produkt të caktuar, do të vazhdojnë të vihet në dispozicion nëpërmjet mekanizimit të të drejtës së informimit.

Prandaj, mekanizmi i të dhënave të hapura do të qëndrojë krah për krah me atë të Programit të Transparencës dhe të drejtën për informim dhe organet/sipërmarrjet publike duhet të kujdesen të plotësojnë detyrimet ligjore që burojnë nga ligje të ndryshme për secilën prej tyre.

Kujdes! Një pjesë e informacionit që është vendosur në rubrikën "Programi i Transparencës" të organeve të sektorit publik, përmban informacion që duhet të vendoset në rubrikën "Opendata". Kjo nuk do të thotë që ky dokument do të hiqet nga rubrika "Programi i Transparencës". Kështu për shembull në rastin e Raportit Vjetor të organit, jo i gjithë raporti duhet vendosur në rubrikën "Opendata", por pjesë që përmbajnë një rëndësi të tillë dhe që mund të përkthehen/transformohen në statistika, apo të dhëna në funksion të Ligjit nr.33/2022 me qëllim ripërdorimin.

II. KOMPETENCAT E KOMISIONERIT

Ligji nr. 33/2022, autorizon Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me përgjegjësinë për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e së drejtës për ripërdorim të dokumenteve. Këto tre kompetenca ndërthuren natyrshëm midis tyre në mënyrë që të sigurohet një sistem efektiv dhe transparent për zbatimin e këtij ligji.



Kompetenca për **mbrojtje** ka të bëjë me garantimin e respektimit të së drejtës për ripërdorim, me të drejtën për të ndërhyrë kur kjo e drejtë cënohet. Ndërkohë që **mbikëqyrja** është mekanizmi që siguron kontrollin e vazhdueshëm mbi organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike, për të parandaluar veprimet apo mosveprimet në kundërshtim me ligjin. **Promovimi** nënkupton një qasje *proaktive* që ndihmon organet në zbatimin e ligjit dhe parandalon situata të moszbatimit të tij, duke rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë dhe përfitimet e të dhënave të hapura dhe krijuar një kulturë të të dhënave të hapura. Sa më efektiv të jetë promovimi, aq më shumë zvogëlohet nevoja për mbrojtje dhe ndërhyrje. Sa më efektive të jetë mbrojtja, aq më shumë rritet mundësia që organet të kuptojnë rëndësinë e dhënave të hapura dhe ripërdorimit dhe për rrjedhojë ulet nevoja për promovim. Për rrjedhojë, zbatimi i qasjes së të dhënave të hapura konsiderohet procesi dinamik, që kërkon ndërveprim të vazhdueshëm midis Zyrës së Komisionerit dhe organeve të sektorit publik dhe sipërmarrjeve publike.

C. KONCEPTET KRYESORE TË LIGJIT

I. PËRKUFIZIMET

1. Formati i lexueshëm nga kompjuteri

Neni 6, pika 3 e Ligjit nr.33/2022, përkufizon se çfarë duhet të kuptojmë me *format i lexueshëm nga kompjuteri*[7]. Një dokument konsiderohet të jetë në një format të lexueshëm nga makineritë/kompjuteri nëse është strukturuar në mënyrë të tillë që aplikacionet softuerike të mund të identifikojnë, njohin dhe nxjerrin lehtësisht të dhëna specifike prej tij. Të dhënat e koduara në skedarët që janë të strukturuara në një format të lexueshëm nga makineritë, duhet të konsiderohen

[7] Konsiderohet formati i strukturuar në mënyrë të tillë që programet informatike të mund të identifikojnë, të njohin e të ekstraktojnë lehtësisht të dhëna të caktuara, përfshirë deklaratat individuale dhe strukturën e tyre të brendshme.

si të dhëna të lexueshme nga makineritë. Këto formate janë të dizajnuara për t'u lexuar nga makinat dhe jo nga njerëzit, duke përdorur struktura të standardizuara të të dhënave ose gjuhë shënjash.

Disa shembuj për efekt të përputhshmërisë teknike janë:

- CSV është një skedar vlerash që lejon të dhënat të ruhen në një format tabelar dhe i bën të thjeshta për tu kopjuar dhe analizuar nga programet kompjuterike.
- JSON është një format që shërben pë ruajtjen dhe transferimin e të dhënave. Ky format luan rolin e një bazë të dhënash të lexueshme nga njerëzit dhe programet kompjuterike.
- XML është një gjuhë skriptimi e cila ruan të dhëna në trajtë të strukturuar gjithashtu edhe në formë të lexueshme nga njeriu dhe programet kompjuterike.
- HTML është një format që përdoret kryesisht për krijimin e faqeve në internet, HTML mund të strukturohet në një mënyrë që është e lexueshme nga makina, veçanërisht me përdorimin e etiketave semantike.
- RDF është një model standard për shkëmbimin e të dhënave në web, duke lejuar që të dhënat të ndahen dhe të ripërdoren nëpër aplikacione.
- YAML është një standard i serializimit të të dhënave të lexueshme nga njeriu që përdoret shpesh për skedarët e konfigurimit, por gjithashtu është lehtësisht i analizueshëm nga makinat.

Në këtë kontekst, për të konsideruar të dhënat "*të hapura*" dhe efektive në një format të lexueshëm nga makinat, ato duhet të jenë të aksesueshme lirisht, të mund të shkarkohen dhe të mund të përdoren nga kushdo, duke mundësuar ndërveprueshmëri dhe analizë efikase të të dhënave.

Kujdes! Formati Pdf nuk përfshihet në kategorinë format i lexueshëm nga kompjuteri. Organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike duhet të sigurohen që publikimi i të dhënave të hapura të jetë në formatin e shembujve të lartpërmendur.

2. Të dhënat e hapura (Open data)

Në nenin 6, pika 15, e Ligjit nr. 33/2022, parashikohet përkufizimi i të dhënave të hapura ose open data. Koncepti i të dhënave të hapura i ka rrënjët në transparencën në qeverisje, pjesëmarrjen e qytetarëve dhe llogaridhënien. Fillesat e të dhënave të hapura janë rreth 25 vite më parë. Nëpërmjet të dhënave të hapura synohej vënia në dispozicion dhe ripërdorimi i çdo të dhëne që nuk konsiderohet sensitive dhe si e tillë e paaksesueshme sipas ligjit, pa asnjë barrierë ligjore, teknologjike apo të një natyre tjetër.
Përkufizimi i përfshirë në Ligj është njësoj me atë të përdorur në Direktivë. Përkufizimi nuk përcakton se kujt i takon kjo përgjegjësi dhe prandaj duhet lexuar në harmoni me parashikimet e

nenit 4 të Ligjit që rregullojnë kufizimet e zbatimit të tij. Për më shumë, referojuni seksionit për kufizimet e zbatimit të ligjit.

Ky ligj zbatohet për dokumente të cilat bëjnë pjesë në detyrat publike të organeve të sektorit publik të përcaktuara me ligj ose me rregulla të tjera detyruese. Detyrat publike mund të përcaktohen në përgjithësi ose rast pas rasti për organet e sektorit publik. Të dhënat publike "të hapura" i referohen informacionit të sektorit publik që mund të aksesohet dhe ripërdoret lehtësisht dhe gjerësisht, në mënyrë ideale në kushte jo kufizuese. Të dhënat e hapura variojnë sipas organit dhe kompetencave të ngarkuara me ligj. Prandaj e dhënë e hapur, mund të jetë çdo e dhënë që nga informacioni qeveritar, statistikat publike deri tek të dhënat shkencore, kërkimore, dhe të tjera të ngjashme.

Kujdes! Se çfarë përbën të dhënë të hapur vendoset rast pas rasti duke patur parasysh kompetencat e organit dhe qëllimin e ligjit. Psh. e dhënë e hapur nuk është vendimi i një institucioni i marrë bazuar në kompetencën që ushtron organi sipas ligjit apo raporti vjetor në vetvete, por tërësia e vendimeve e strukturuar në format të hapur i cili përmban elementet e vendimeve, apo të dhënave të raportit vjetor.

Të dhënat e hapura janë thelbësore për disa arsye, të renditura më poshtë, duke ofruar përfitime të shumta:

Transparenca dhe Llogaridhënia: Hapja e të dhënave promovon transparencën në qeverisje duke e bërë informacionin në lidhje me aktivitetet, vendimet dhe shpenzimet e qeverisë të aksesueshme për publikun. Kjo transparencë nxit llogaridhënien pasi qytetarët mund të shqyrtojnë veprimet e qeverisë dhe ndihmon në zbulimin e padrejtësive apo keq menaxhimit të burimeve.

Inovacioni dhe zhvillimi ekonomik: Të dhënat e hapura shërbejnë si një katalizator për inovacionin. Duke ofruar akses në grupet e të dhënave, ai u mundëson sipërmarrësve, studiuesve dhe zhvilluesve të krijojnë produkte, shërbime dhe zgjidhje të reja. Kjo mund të ndihmojë në rritjen e konkurrencës, në zhvillimin ekonomik, duke krijuar mundësi pune, dhe duke tërhequr investime.

Vendimmarrja e përmirësuar: Të dhënat e hapura mund të ndihmojnë në përmirësimin e proceseve vendimmarrëse duke ofruar bazën e duhur të informacionit për politikat dhe vendimet, që do të ndërmerren në të ardhmen.

Fuqizimi i pjesëmarrjes qytetare: Hapja e të dhënave lejon qytetarët të jenë më të përfshirë në procesin vendimmarrës dhe të kenë një rol më të madh në monitorimin dhe vlerësimin e veprimtarisë së qeverisë.

Shërbime publike të përmirësuara: Të dhënat e hapura mund të përmirësojnë ofrimin e shërbimeve publike duke lehtësuar vendimmarrjen dhe ofrimin e shërbimeve të bazuara në të dhëna. Për shembull, të dhënat e hapura të shëndetit mund të informojnë politikat e shëndetit publik, ndërsa të dhënat e hapura të transportit mund të përmirësojnë planifikimin urban dhe shërbimet e transportit.

Nxitja e bashkëpunimit: Të dhënat e hapura inkurajojnë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e njohurive në të gjithë sektorët. Duke ndarë të dhënat, organizatat mund të bashkëpunojnë në projekte kërkimore, për hulumtimin dhe zhvillimin e zgjidhjeve për sfidat komplekse shoqërore, mjedisore dhe ekonomike.
Hapja e të dhënave mund të mobilizojë edhe komunitetet për të përdorur informacionin e për të qenë pjesëmarrës në zgjidhjen e problemeve lokale për të përmirësuar cilësinë e jetës së tyre.
Promovimi i barazisë dhe përfshirjes: Të dhënat e hapura kanë potencialin për të reduktuar pabarazitë dhe për të promovuar përfshirjen sociale. Duke i bërë të dhënat të aksesueshme për të gjithë, sigurohet që komunitetet e margjinalizuara të kenë mundësi të barabarta për të përfituar nga zgjidhjet dhe risitë teknologjike.

Çfarë i bën të dhënat të hapura?



Të dhënat konsiderohen të hapura nëse plotësojnë tre kritere kryesore:

Qasje falas: Të dhënat duhet të jenë lehtësisht të disponueshme, në internet përmes portalit të dhënave të hapura (opendata.gov.al). Të gjithë mund ti përdorin të dhënat e hapura pa asnjë pengesë (teknike, ligjore apo financiare). Grupet e të dhënave janë të lira për t'u aksesuar, ose

kundrejt një tarife vetëm nëse kanë ndonjë kosto shtesë (riprodhimi, shpërndarja, anonimizimi i të dhënave personale, mbrojtje sekreti tregtar).

Disponueshmëria: Të dhënat e hapura duhet të jenë të disponueshme në mënyrë të barabartë për të gjitha grupet, duke përfshirë: individët, kompanitë e sektorit privat, studiuesit dhe autoritetet publike.

Ripërdorimi i të dhënave: Të gjithë duhet të jenë në gjendje t'i përdorin, ripërdorin dhe rishpërndajnë të dhënat, në formate lehtësisht të kuptueshme, për çfarëdo qëllimi.

Palët që aksesojnë të dhënat duhet të lejohen t'i ripërdorin dhe rishpërndajnë ato, duke përfshirë kombinimin e tyre me grupe të tjera të dhënash duke respektuar licencën dhe detyrimin për t'i atribuuar të dhënave burimin dhe për të ndarë çdo grup të ri të dhënash të prodhuar. Ka mjete të ndryshme (si API-të, miniaplikacionet) që lejojnë palët e treta të ripërdorin të dhënat e publikuara.

Më poshtë jepen disa hapa të përgjithshme që duhen ndjekur nga organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike për të hapur të dhënat e tyre:

1. *"Identifikimi i të dhënave",* të cilat ofrohen si të dhëna të hapura (Lista);
2. *"Pastrimi i të dhënave"* , për të hequr fushat e pasakta ose të paplota;
3. *"Standardizimi i të dhënave",* duke siguruar që të dhënat të jenë në të njëjtin format;
4. *"Anonimizimi"*, për të hequr çdo informacion mbi të dhënat personale, mbrojtjen e informacionit sekret tregtar, etj. referuar kufizimeve të nenit 4 të Ligjit nr. 33/2022, përpara se të ndahet.
5. *"Funksionimi i një portali si një platformë unike për publikimin e të dhënave të hapura – opendata.gov.al";* Platforma ekzistuese alternative, janë faqet zyrtare të çdo organi të sektorit publik dhe sipërmarrjeve publike, apo edhe rrjetet sociale.
6. *"Promovimi i publikimit të të dhënave dhe qasjen e tyre"*: Të dhënat duhet të publikohen në platformën e zgjedhur dhe duhet të jenë lehtësisht të gjetshme dhe të aksesueshme për publikun. Promovimi i qasjes së tyre nëpërmjet rrjeteve sociale, mediave dhe aktiviteteve të tjera sensibilizuese.
7. *"Monitorimi dhe përditësimi",* monitorimi i përdorimit të të dhënave të hapura dhe përditësimi i tyre, sipas nevojave dhe kërkesave të përdoruesve.

Nevoja për të dhëna cilësore

Përgatitja e të dhënave të hapura për publikim është një hap thelbësor për të siguruar cilësinë, përdorshmërinë dhe aksesueshmërinë e tyre.

Për këtë arsye të dhënat dhe burimet e tyre duhet të kenë disa karakteristika, renditur si më poshtë:

- të jenë të sakta;
- në kohë reale;

- të besueshme;
- gjithëpërfshirëse;
- të gjetshme, të arritshme, të ndërveprueshme e të ripërdorshme nga kushdo e për çdo qëllim.

Të dhënat duhet të ruhen në formate që janë lehtësisht të lexueshëm nga makina, në mënyrë që të jetë i mundur një përpunim i automatizuar dhe i strukturuar i tyre. Të dhëna të disponueshme, që nuk mund të përpunohen, nuk janë të dobishme për sa kohë që të dhënat nuk mund të transformohen nga formate të ndryshme në informacione të zbatueshme për veprime apo vendime inteligjente.

Garantimi i cilësisë së të dhënave është një proces kritik dhe është thelbësor për suksesin e programeve të të dhënave të hapura.

Për këtë arsye është e nevojshme të merren masat e mëposhtme:

- Miratimi i një strukture të qeverisjes së të dhënave, që përmban procese për të kontrolluar dhe nëse është e nevojshme për të përmirësuar cilësinë nga burimet e hapura të të dhënave;
- Trajnimi i punonjësve "kujdestarët e të dhënave", të cilët janë përgjegjës për cilësinë e grupeve të të dhënave. Ata duhet të dinë se nga kanë ardhur të dhënat (burimi i të dhënave), sa shpesh përditësohen, sa kohë duhet të mbahen dhe nga cilat sisteme kanë kaluar ose janë pasuruar;
- Standardizimi i një platforme qendrore për të siguruar cilësinë e të dhënave.

3. Ripërdorimi

Për sa i takon ripërdorimit, për të evidentuar kuptimin e plotë, lipset të lexohen së bashku disa dispozita të ligjit. Kështu neni 6, pika 11, jep përkufizimin e termit "*Ripërdorim*"[8]. Në nenin 7 parashikohet "*E drejta për ripërdorim*", ndërsa neni 8 lidhet me "*Trajtimin e kërkesës*". Organet e sektorit publik mbledhin, prodhojnë, riprodhojnë dhe shpërndajnë dokumente për të përmbushur

[8] "*Ripërdorimi është përdorimi nga ana e personave fizikë ose juridikë i dokumenteve që mbahen nga organet e sektorit publik në kuadër të detyrës publike ose sipërmarrjeve publike në kuadër të shërbimeve që ato ofrojnë, për qëllime tregtare ose jo, të ndryshme nga qëllimi fillestar për të cilin dokumenti është prodhuar. Shkëmbimi i dokumenteve ndërmjet organeve të sektorit publik ose ndërmjet sipërmarrjeve publike dhe organeve të sektorit publik në përmbushje të detyrave publike të organeve të sektorit publik nuk përbën ripërdorim".*

detyrat e tyre publike. Sipërmarrjet publike mbledhin, prodhojnë, riprodhojnë dhe shpërndajnë dokumente për të ofruar shërbime në interes të përgjithshëm. Përdorimi i këtyre dokumenteve për arsye të tjera përbën ripërdorim.

Ripërdorimi nënkupton që e dhëna/informacioni nuk është objekt i kufizimeve ligjore si informacion i paaksesueshëm, si për shembull në rastin e të dhënave për sigurinë kombëtare, shërbimet sekrete etj.

Për sa kohë të dhënat/informacioni nuk i nënshtrohet këtyre kufizimeve ato duhet **të jenë të përdorshme për qëllime tregtare dhe jo-tregtare.**



Aksesi në të dhëna/informacion është parakusht për ripërdorimin dhe prandaj pa atë s'mund të ketë ripërdorim. Prandaj informacioni/e dhëna ka më shumë vlerë kur ndahet dhe bëhet publike në rubrikën të dhëna të hapura. Ligji parashikon që të dhënat publike dhe të dhënat që përftohen nëpërmjet fondeve publike, duhet të jenë të përdorshme për qëllime tregtare dhe jo-tregtare.

Ripërdorimi lidhet me procesin e vlerësimit, përdorimit dhe shpërndarjes së informacionit/të dhëna publike të disponueshme, për qëllime që shkojnë përtej qëllimit fillestar për të cilin ky informacion/e dhënë është mbledhur/hartuar apo krijuar.

Sa më sipër, përfshin një gamë të gjerë veprimesh të tilla si integrimi i të dhënave në aplikacione, përdorimi për kërkim shkencor, përmirësimin e shërbimeve apo krijimi i produkteve të ndryshme.

Parimet bazë që lidhen me ripërdorimin në BE përfshijnë:

1. **Aksesin:** të dhënat duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe shkarkueshme, në formatin e lexueshëm nga kompiuteri.
2. **Akses jo diskriminues**: të dhënat duhet të jenë të disponueshme për të gjithë përdoruesit, pa krijuar avantazhe për persona apo grupe të caktuara.

3. **Licenca:** të dhënat e hapura duhet të jenë të licensuara, me qëllim ripërdorimin dhe rishpërndarjen sipas kushteve të tyre (shiko për më shumë pjesën "Licencat")
4. **Inovacioni**: nëpërmjet ripërdorimit të të dhënave, bizneset, SME, kërkuesit shkencor, organet e sektorit publik i japin vlerë të re produkteve apo shërbimeve.

4. Të dhënat kërkimore

Neni 6, pika 16 e Ligjit nr. 33/2022, përcakton çfarë konsiderohet e dhënë kërkimore.[9]

Përfshirja e të dhënave kërkimore si pjesë të të dhënave të hapura, për sa kohë kërkimi shkencor financohet me fonde publike ka qenë një nga risitë e vetë Direktivës. Në këtë kuadër, Ligji nr. 33/2022 përcakton se këto të dhëna, janë të disponueshme për ripërdorim me qëllim fitimi ose jo, duke respektuar të drejtat e pronësisë intelektuale, mbrojtjen e të dhënave personale, konfidencialitetin, sigurinë e interesat tregtare legjitime.

Për studiuesit, organizatat e kryerjes së kërkimeve ose organizatat e financimit të kërkimeve, këto detyrime zbatohen për të dhënat kërkimore vetëm nga momenti që ato bëhen publike prej tyre.

Aksesi në të dhëna kërkimore bëhet bazuar në parimin "e hapur sa është e mundur, e mbyllur sa është e nevojshme" dhe sipas parimeve FAIR (e gjetshme, e aksesueshme, e ndërveprueshme, e ripërdorshme). Politikat e aksesit të hapur synojnë në veçanti t'u japin kërkuesve dhe publikut në përgjithësi akses në të dhënat e kërkimit sa më shpejt që të jetë e mundur në procesin e shpërndarjes dhe të lehtësojnë përdorimin dhe ripërdorimin e tyre. Aksesi i hapur ndihmon në përmirësimin e cilësisë, reduktimin e nevojës për dyfishim të panevojshëm të kërkimit, përshpejtimin e përparimit shkencor, luftimin e mashtrimeve shkencore dhe mund të favorizojë në përgjithësi rritjen ekonomike dhe novacionin.

5. Të dhënat dinamike

Në nenin 6, pika 14, e ligjit nr. 33/2022, parashikohet se: "Të dhëna dinamike" janë dokumente në formë digjitale, që u nënshtrohen përditësimeve të shpeshta ose në kohë reale, në veçanti për shkak të paqëndrueshmërisë së tyre ose vjetrimit të shpejtë. Të dhënat e gjeneruara nga sensorët zakonisht

[9] "*Të dhëna kërkimore"* janë dokumente në format digjital, si: statistika, rezultate eksperimentesh, matje, vëzhgime që vijnë nga puna në terren, rezultate anketimesh, regjistrime intervistash dhe imazhe, duke përfshirë edhe të dhënat meta (metadata), specifikime dhe objekte të tjera digjitale, përveç publikimeve shkencore, të cilat mblidhen ose krijohen gjatë veprimtarive të kërkimit shkencor dhe përdoren si provë në procesin kërkimor.

konsiderohen të dhëna dinamike. Shembuj të të dhënave dinamike janë, të dhënat mjedisore, të trafikut, satelitore apo meteorologjike. Të dhënat dinamike janë një nga llojet më të vlefshme nga këndvështrimi i biznesit, pasi ato mund të përdoren për produktet dhe shërbimet që ofrojnë informacion në kohë reale, të tilla si aplikacionet e udhëtimit apo transportit.
Duke marrë parasysh se vlera ekonomike e këtij lloji të dhënash varet nga disponueshmëria e menjëhershme e informacionit dhe përditësimeve të rregullta, të dhënat dinamike, duhet të vihen në dispozicion për t'u ripërdorur menjëherë pas mbledhjes nëpërmjet API-ve të përshtatshme dhe, kur është e mundur, përmes shkarkimeve me shumicë.

Në vijim, përmendim disa nga karakteristikat e të dhënave dinamike, si:

- **Përditësimi në kohë reale:** Të dhënat dinamike përditësohen shpesh për të pasqyruar informacionin më aktual. Kjo mund të ndodh automatikisht përmes furnizimeve të të dhënave ose API-ve.
- **Interaktiviteti:** Përdoruesit mund të ndërveprojnë me të dhënat dinamike, shpesh përmes aplikacioneve ose paneleve që lejojnë filtrimin, renditjen dhe vizualizimin e të dhënave në mënyra të ndryshme.
- **Rëndësia kontekstuale:** Rëndësia e të dhënave dinamike mund të ndryshojë në bazë të kohës, vendndodhjes ose hyrjes së përdoruesit, duke e bërë atë veçanërisht të dobishme për aplikacionet që kërkojnë informacion në kohë.
- **Kompleksiteti:** Të dhënat dinamike mund të jenë më komplekse për t'u menaxhuar dhe analizuar në krahasim me të dhënat statike, pasi mund të përfshijnë rrjedha të vazhdueshme informacioni nga burime të ndryshme.

6. Të dhënat me vlerë të madhe

Organet e sektorit publik prodhojnë, mbledhin dhe paguajnë për sasi të mëdha të dhënash, të njohura si informacione të sektorit publik ose të dhëna qeveritare.

Ligji nr. 33/2022 fut konceptin e kategorive të të dhënave me vlerë të madhe, të përcaktuara si të dhëna që janë të lidhura me përfitime të rëndësishme për shoqërinë dhe ekonominë kur ripërdoren. Kjo kategori të dhënash shërben edhe si burim kryesor për zhvillimin e inteligjencës artificiale. Këto grupe të dhënash, janë subjekt i një sërë rregullash më ambicioze (shih nenin 17 të Ligjit) në mënyrë që të ulin ndjeshëm pengesat e hyrjes në treg si brenda edhe jashtë vendit dhe të rrisin volumin e të dhënave të ripërdorura.

Në grupin e të dhënave me vlerë të madhe, bazuar në nenin 16 të Ligjit, përcaktohen kategoritë tematike të tyre, që përmblidhen në 6 (gjashtë) fusha si:



Në frymën e Direktivës, ligji në nenin 16, pika 2, ka përcaktuar shtimin e kategorive tematike të grupeve të të dhënave me vlerë të madhe sa herë është e nevojshme me qëllim reflektimin e zhvillimeve teknologjike dhe zhvillime të tregut.

Në zbatim të këtij neni, me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 444, datë 03.07.2024 *"Për shtimin e kategorive tematike të grupeve të të dhënave me vlerë të madhe"* është shtuar kategoria e të dhënave me vlerë të madhe "të lëvizshmërisë". Gjithashtu, me këtë VKM janë përcaktuar grupet specifike të të dhënave me vlerë të madhe të lëvizshmërisë dhe të transportit publik e janë përcaktuar masat për publikimin e ripërdorimin, kushtet e zbatueshme për ripërdorim si dhe kërkesat minimale për shpërndarjen e të dhënave nëpërmjet ndërfaqeve të përdorimit të aplikimit (në vijim "API").

Shembuj të grupeve të të dhënave me vlerë të madhe janë ato si:

- Të dhëna gjeohapësinore (referuar Direktivës INSPIRE) të cilat janë të publikuara në portalin https://geoportal.asig.gov.al/, ku gjejmë të dhëna për mjedisin, meteorologjinë, transportin, etj (*referuar nenit 11 të Ligjit nr.72/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"*).
- Të dhënat mbi bizneset e regjistruara janë të publikuara në faqen https://qkb.gov.al/;
- Të dhënat statistikore gjenden të publikuara në faqen https://instat.gov.al/al,... etj.

7. Metadata

Metadata përkufizohet në nenin 6, pika 7[10] e Ligjit nr. 33/2022. Në kontekstin e zbatimit të ligjit, brenda në rubrikën e të dhënave të hapura, do të duhet të vendosen edhe metadata. Metadata orienton mbi elemente si përmbajtja, struktura, burimi, formati dhe koha e krijimit të të dhënave.

Shembuj të Metadata-s:

- **Në dokumentet dixhitale:** Emri i autorit, data e krijimit, formati i skedarit.
- **Në të dhënat gjeohapësinore:** Koordinatat gjeografike, shkalla e hartës, burimi i informacionit.

II. MARRËVESHJET EKSKLUZIVE

Në nenin 15 të Ligjit nr. 33/2022, parashikohet instituti i marrëveshjeve ekskluzive[11]. Bazuar në parimin e mosdiskriminimit, ripërdorimi është i hapur për të gjithë dhe prandaj marrëveshjet dhe kontratat e tjera midis organit dhe palëve të treta nuk duhet të garantojnë asnjë të drejtë ekskluzive.

Në frymën e Direktivës, edhe ligji vendas synon të parandalojë nënshkrimin e marrëveshjeve të ekskluzivitetit që mund të shpien në ekskluzivitet të ripërdorimit nga ana e subjekteve private. Në parim, ekziston mundësia që nëpërmjet marrëveshjeve të ekskluzivitetit, subjektet private të monopolizojnë ripërdorimin për të gjithë aktorët e ekosistemit. Pavarësisht kësaj, ligji njeh të drejtën ekskluzive për ofrimin e një shërbimi publik duke e lidhur atë me garanci në lidhje me publikimin dhe afatin e kësaj të drejte. Edhe pse Direktiva lejonte që shtetet të specifikonin llojin

[10] Çdo e dhënë që jep informacion mbi të dhëna të tjera.
[11] "1. Ripërdorimi i dokumenteve është i hapur për të gjithë. 2. Marrëveshjet dhe kontratat e tjera ndërmjet organeve të sektorit publik ose sipërmarrjeve publike që zotërojnë dokumente dhe palëve të treta nuk duhet të garantojnë asnjë të drejtë ekskluzive për ripërdorim. 3. Pika 2 e këtij neni nuk gjen zbatim në rastet kur është e nevojshme një e drejtë ekskluzive për ofrimin e një shërbimi me interes publik, arsyeja për dhënien e së cilës shqyrtohet rregullisht, jo më pak se një herë në çdo 3 vjet. Marrëveshjet ekskluzive të nënshkruara nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe në vijim bëhen publike në internet të paktën 2 muaj para hyrjes së tyre në fuqi. Kushtet përfundimtare të këtyre marrëveshjeve janë transparente dhe bëhen publike në internet. 4. Kur e drejta ekskluzive lidhet me digjitalizimin e burimeve kulturore, periudha e ekskluzivitetit nuk duhet t'i kalojë 10 vjetët. Kur ajo i kalon 10 vjetët, kohëzgjatja shqyrtohet gjatë vitit të 11-t dhe, nëse është rasti, çdo 7 vjet pas tij. 5. Marrëveshjet ligjore, që, pa dhënë shprehimisht një të drejtë ekskluzive, synojnë ose mund të çojnë në vënien në dispozicion në mënyrë të kufizuar të ripërdorimit të dokumenteve nga subjekte të tjera përveç palëve të treta që marrin pjesë në marrëveshje, bëhen publike në internet të paktën 2 muaj para hyrjes në fuqi të tyre. 6. Efekti i këtyre marrëveshjeve ligjore për disponueshmërinë e të dhënave për ripërdorim vlerësohet çdo 3 vjet."

e shërbimit për interes publik, legjislatori ka zgjedhur t'i qëndrojë formulimit gjeneralist të Direktivës.

Formulimi i jep diskrecion organit të sektorit publik apo sipërmarrjes publike që duhet ta ushtrojnë atë në mënyrë proporcionale. Pjesë e analizës që do të duhet të kryejë organi apo sipërmarrja publike janë aspektet ekonomike që lidhen me zhvillimin e një produkti apo shërbimi në interes publik, që do të ishte e papërballueshme financiarisht për subjektin privat, nëse nuk do të garantohej e drejta e ekskluzivitetit.

Në të njëjtën linjë me Direktivën, edhe Ligji veçon *"digjitalizimin e burimeve kulturore"* duke përfshirë një rregullim të posaçëm. Kjo lloj ndërmarrje konsiderohet veçanërisht e kushtueshme dhe subjekti privat duhet të investojë vlera të mëdha në digjitalizimin e koleksioneve/veprave që ruhen nga bibliotekat, përfshirë bibliotekat universitare, muzetë dhe arkivat[12]. Në lidhje me këtë kategori, Ligji parashikon se afati fillestar është 10 vjeçar, por mund të ketë zgjatje edhe për 7 vite të tjera. Kjo do të thotë që të gjithë ato subjekte private që do të angazhohen në digjitalizimin e biblotekave kanë të drejtën të gëzojnë ekskluzivitet për aksesin në ripërdorim për 10 vite, por edhe më gjatë. Ky kufizim përligjet në kushtet e investimit të subjektit privat për të rekuperuar investimin financiar fillestar, që në fakt mundëson digjitalizimin e veprave. Në të gjitha rastet, pas përfundimit të afatit të ekskluzivitetit, dokumentet/të dhënat e digjitalizuara rikthehen në duart e organit të sektorit publik.

III. HARTËZIMI I ORGANEVE TË SEKTORIT PUBLIK/SIPËRMARRJEVE PUBLIKE

Organet e sektorit publik

Në nenin 6, pika 9 të Ligjit, jepet përkufizimi i organeve të sektorit publik.[13] Por ky përkufizim duhet lexuar në harmoni me parashikimet e nenit 4, pika 1, shkronja f), g), gj)[14]. Për rrjedhojë, lista

[12] Neni 4, pika 1, shkronja g) përjashton nga zbatimi i këtij ligji institucionet kulturore; por nga ky përjashtim, bën përjashtim institucione si bibliotekat, përfshirë bibliotekat universitare, muzetë dhe arkivat;
[13] përfshin çdo organ të pushtetit qendror, i cili kryen funksione administrative; çdo organ të enteve publike, në masën që ato kryejnë funksione administrative; çdo organ të pushtetit vendor që kryen funksione administrative; çdo organ të Forcave të Armatosura, për aq kohë sa kryejnë funksione administrative, si dhe çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdolloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve administrative publike".
[14] f) të Radiotelevizionit Publik Shqiptar (RTSH) dhe të institucioneve të varësisë së tij në kuadër të përmbushjes së funksionit të shërbimit të transmetimit publik; g) të institucioneve kulturore, duke bërë përjashtim nga këto institucione bibliotekat, përfshirë bibliotekat universitare, muzetë dhe arkivat; gj) të institucioneve të arsimit parauniversitar dhe institucioneve të arsimit të lartë;

e organeve të sektorit publik përfshin institucionet e evidentuara në Aneksin 1, të kategorizuar si më poshtë:

a) *organe të pushtetit qendror, të cilët kryejnë funksione administrative;*
b) *çdo organ të enteve publike, në masën që ato kryejnë funksione administrative;*
c) *çdo organ të pushtetit vendor që kryen funksione administrative;*
d) *çdo organ të Forcave të Armatosura, për aq kohë sa kryejnë funksione administrative;*
e) *si dhe çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdolloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve administrative publike.*

Në total, referuar kuadrit ligjor në fuqi, janë identifikuar 310 subjekte të ligjit. Gjithësesi, kjo listë do të jetë objekt i përditësimit të vazhdueshëm në përputhje me ndryshimet ligjore sa i përket organizimit të organeve të sektorit publik.

Nga leximi tërësor i listës, evidentohet që këto institucione **nuk janë objekt i zbatimit të këtij ligji**:

(i) Radiotelevizioni Publik Shqiptar (RTSH) dhe institucionet e varësisë së tij në kuadër të përmbushjes së funksionit të shërbimit të transmetimit publik. Nisur nga natyra lehtësisht e individualizueshme e RTSH, përjashtimi nga zbatimi i Ligjit nuk lë vënd për interpretime.
(ii) institucionet kulturore, duke bërë përjashtim nga këto institucione bibliotekat, përfshirë bibliotekat universitare, muzetë dhe arkivat. Përjashtimet përfshijnë të gjitha ato institucione që sipas legjislacionit të fuqi kategorizohen si biblioteka, muze apo arkiva, pavarësisht natyrës lëndore të tyre (për shembull Arkivi Qendror i Filmit).

Ligj nr.10 352, datë 18.11.2010 "Për artin dhe kulturën", ndryshuar në nenin 5 përcakton "*Ndarja e institucioneve të artit e të kulturës*"[15]. Nga leximi i kësaj dispozite dhe asaj të Ligjit nr.33/2022 rezulton se institucioneve kulturore, si orkestrat, operat, baletet dhe teatrot, janë jashtë fushës së këtij ligji për shkak të specifikës së tyre si artet e skenës dhe faktit se pothuajse i gjithë materiali i tyre i nënshtrohet të drejtave të pronësisë intelektuale të palëve të treta.
Për sa i takon kuptimit të togfjalëshit *"institucioneve kulturore*", Ligji nr.27/2018*"Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë"*, i përditësuar nuk përmban një përkufizim të tij. Në këtë ligj

[15]1. Institucionet e artit dhe të kulturës janë subjekte publike dhe private. 2. Institucionet publike të artit e të kulturës ndahen në qendrore dhe vendore. 3. Në institucionet publike qendrore të artit e të kulturës, subjekt i këtij ligji, përfshihen: a) Teatri Kombëtar; b) Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor; c) Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave; ç) Qendra Kombëtare e Artit dhe Kulturës; d) Galeria Kombëtare e Arteve; dh) Cirku Kombëtar; e) Teatri Kombëtar i Komedisë. 4. Në institucionet publike vendore të artit e të kulturës përfshihen institucionet e artit dhe kulturës, në varësi të njësisë së qeverisjes vendore

përdoret terminologjia "*institucionet publike të specializuara"*. Neni 28 detajon kush konsiderohet institucion i specializuar.[16] Por, edhe kjo listë nuk mund të konsiderohet shterruese për efekt të zbatimit të Ligjit nr.33/2022 dhe kuptimit të togfjalëshit *"institucione kulturore"*. Duke qenë se ligje të tjera mund të përcaktojnë statusin apo klasifikimin si "institucion kulturor", mbetet vlerësim rast pas rasti dhe objekt i përditësimit të vazhdueshëm.

Shembull për institucione kulturore që nuk janë objekt i këtij Ligji:
Teatri Kombëtar, Teatri i Operas dhe Baletit, Galeria Kombëtare e Arteve, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe i Studimit të Arteve, Instituti i Arkeologjisë, Parqet Arkiologjike.

(iii) institucionet e arsimit parauniversitar dhe institucioneve të arsimit të lartë, sipas legjislacionit në fuqi. Ligji nr. 69/2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, në nenin 14 përcakton: "Institucionet në sistemin arsimor parauniversitar"[17]. Më tej, neni 6/9 të Ligjit nr. 80/2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në republikën e shqipërisë"* përcakton "Institucionet e arsimit të lartë"[18]. Referuar këtyre parashikimeve institucionet arsimore të çdo niveli janë të përjashtuara nga fusha e veprimit të këtij ligji. Megjithatë, ministria përgjegjëse për arsimin, në rubrikën përkatëse të të dhënave të hapura, do të duhet të përfshijë të dhëna statistikore, për shembull mbi numrin total të institucioneve të arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, shpërndarjen gjeografike të tyre, numrin e punonjësve, nxënësve apo edhe të dhëna të tjera të nevojshme. Ngjashmërisht, të dhëna përkatëse duhet të jepen edhe për institucionet e arsimit të lartë.

[16] 1. Institucione të specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore janë: a) Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore; b) Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore; c) Drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore; ç) Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale; d) Institucionet e Rrjetit Arkivor Kombëtar; dh) Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë; e) Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe i Studimit të Arteve; ë) Instituti i Arkeologjisë.

[17] "Në sistemin arsimor parauniversitar funksionojnë kopshtet, shkollat dhe institucionet plotësuese, të cilat janë publike ose private."

[18] janë personat juridikë që ofrojnë arsimim të lartë ose kualifikim profesional pas arsimit të mesëm dhe, sipas llojit të institucionit, edhe kërkim shkencor, si pjesë e sistemit të arsimit të lartë, të krijuar, dhe që ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi

Sipërmarrjet publike

Neni 6, pika 12 e Ligjit përkufizon sipërmarrjet publike.[19] Ky nen duhet lexuar dhe interpretuar në harmoni me nenin 3, shkronja b)[20] të tij. Nisur nga sa më sipër, rezulton se sipërmarrjet publike që kanë detyrimin për të zbatuar këtë ligj, janë vetëm ato të cilat ofrojnë shërbime të interesit të përgjithshëm në sektorët e ujit, energjitikës, transportit dhe shërbimeve postare apo veprojnë si operatorë të shërbimeve të transportit publik, rrugor, ajror, dhe detar, si dhe që mbajnë të dhënave kërkimore. Për ta ilustruar me shembuj konkret nga praktika, në Aneksin 2 gjendet lista e disa prej sipërmarrjeve publike në Shqipëri të cilat janë pjesë e fushë zbatimit të këtij ligji. Kjo listë do të jetë objekt i përditësimit në përputhje me ndryshimet në kuadrin ligjor.

IV. KUFIZIMET NË ZBATIMIN E LIGJIT

Neni 4 i Ligjit parashikon katergoritë e të dhënave si dhe organet e sektorit publik që nuk janë objekt i detyrimeve të tij. Nëpërmjet përjashtimit nga zbatimi, synohet të krijohet një ekuilibër i drejtë midis parimit të transparencës dhe nevojës për të mbrojtur të dhëna/informacione specifike të cilat, nëse do të ishin objekt i këtij Ligji, mund të cënonin interesat shtetërore, privatësinë e individëve apo konkurrencën e ndershme në treg.

Në mënyrë tabelare përmblidhen përjashtimet sipas natyrës të tyre.

	Kategoria e përjashtimeve	**Rerefenca ligjore**
1	Për shkak të natyrës së informacionit	a, b, e
2	Për shkak të pronësisë intelektuale	c
3	Për shkak të sigurisë dhe konfidencialitetit	ç (i, ii, iii), d
4	Për shkak të mbrojtjes së privatësisë dhe të dhënave personale	dh, ë
5	Për shkak të natyrës së institucioneve	f, g, gj
6	Për shkak të natyrës së kërkimeve shkencore	h

[19] "Sipërmarrje publike" është çdo sipërmarrje që vepron në fushat e përcaktuara në shkronjën "b" të nenit 3 të këtij ligji, mbi të cilën organet e sektorit publik mund të ushtrojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi një ndikim dominues për shkak të pronësisë që kanë mbi të, të pjesëmarrjes së tyre financiare në të apo nëpërmjet rregullave që e qeverisin atë. Ndikimi i organeve të sektorit publik në sipërmarrje publike vlerësohet kur organet e sektorit publik, drejtpërdrejt apo tërthorazi: a) kanë shumicën e aksioneve të sipërmarrjes; b) kontrollojnë shumicën e votave lidhur me aksionet e hedhura në treg nga sipërmarrja; c) mund të emërojnë më shumë se gjysmën e organit administrativ, drejtues apo mbikëqyrës të sipërmarrjes.

[20] dokumenteve ekzistuese që mbahen nga sipërmarrjet publike:
i. që kryejnë veprimtari sektoriale sipas ligjit për prokurimet publike në ofrimin e shërbimeve të interesit të përgjithshëm në sektorët e ujit, të energjetikës, të transportit dhe të shërbimeve postare;
ii. veprojnë si operatorë të shërbimeve të transportit publik, rrugor, ajror e detar;

Për sa i takon shkronjës a), përjashtimet kanë të bëjnë me dokumente që për shkak të natyrës së tyre janë jashtë objektit të veprimtarisë së institucionit publik. Ngjashmërisht, edhe shkronja b) dhe e) kanë karakter përjashtues për shkak se shkojnë 'përtej' objektit të ofrimit të shërbimit me interes të përgjithshëm ose kur nuk janë subjekt i rregullave të prokurimit publik, apo sepse janë logo, stema dhe shenja. Për sa i takon termit logo/stema apo shenja ato lidhen me logot e vetë organit apo sipërmarrjes, për shembull logo KDIMDP apo e një klubi futbolli. Ato nuk mund të përdoren pa lejen e vetë organit. E dhënë e hapur duhet të jetë vetëm ajo e dhënë që lidhet me objektin e veprimtarisë të organit apo sipërmarrjes.

Përjashtimi në shkronjën c) lidhet me të drejtat e pronësisë intelektuale që gëzojnë palë të treta mbi të dhënën përkatëse. Përjashtimi nënkupton në vetvete mbrojtje për personat e tretë duke parandaluar cënim të mundshëm të këtyre të drejtave.
Më tej, ligji përjashton publikimin e dokumenteve që përmbajnë të dhëna sensitive, përfshirë ato që përjashtohen për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, të mbrojtjes ose të sigurisë publike (shkronja ç, nën-pika i), konfidencialitetin statistikor (shkronja ç, nën-pika ii), apo edhe konfidencialitetin e të dhënave tregtare ose profesionale (shkronja ç, nën-pika iii) si dhe ato të mbrojtura për shkak të infrastrukturës kritike dhe të dhënave sensitive (shkronjë d).

Përjashtimi sipas shkronjës dh) lidhet me ato dokumente, aksesi të cilave është i kufizuar nga ligji për të drejtën e informimit. Në të njëjtën linjë edhe shkronja ë), përjashton publikimin e dokumenteve që përmbajnë të dhëna personale dhe ripërdorimi i tyre nuk është në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Gjithashtu, ligji parashikon edhe përjashtime që lidhen me llojin/kategorinë e organeve. Prandaj, nuk janë objekti i zbatimit të këtij ligji dokumentet e Radiotelevizionit Publik Shqiptar (RTSH) dhe institucioneve të varësisë së tij (shkronja f) si dhe dokumentet e institucioneve kulturore, me përjashtim të bibliotekave, muzeve dhe arkivave (shkronja g) si dhe ato të institucioneve të arsimit parauniversitar dhe të arsimit të lartë (shkronja gj). Këto organe, referuar kompetencave përkatëse, krijojnë dhe ruajnë materiale unike ose informacione tepër të specializuara që nuk mund të jenë të hapura për publikun e gjerë në formën e open data, pasi ato publikohen/vihen në dispozicion në një mënyrë tjetër.

Së fundmi, ligji parashikon (shkronja h) që dokumente që lidhen me kërkimet shkencore në zotërim të organizatave kërkimore dhe institucioneve të financimit të kërkimeve, janë të përjashtuara nga detyrimi për zbatimin e ligjit. Ky parashikim ka karakter të posaçëm përkundrejt atij të nenit 3, shkronja c) që lejon si të disponueshme për ripërdorim të dhënat kërkimore, si: statistika, rezultate eksperimentesh, matje, vëzhgime që vijnë nga puna në terren, rezultate anketimesh, regjistrime intervistash e imazhe, duke përfshirë edhe të dhënat meta (metadata), specifikime dhe objekte të tjera digjitale dhe nenit 13 të ligjit.

D. DETYRIMET E SEKTORIT PUBLIK PËR DHËNAT E HAPURA

I. KU I GJEJMË TË DHËNAT E HAPURA?

Të dhënat e hapura publikohen në faqet zyrtare përkatëse të organeve të sektorit publik dhe sipërmarrjet publike në Republikën e Shqipërisë.
Gjithashtu, është krijuar portali qendror www.opendata.gov.al për të bashkuar katalogët e të dhënave të hapura të publikuara nga organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike. Ai është krijuar për ta bërë sa më të thjeshtë të jetë e mundur që të gjithë të kenë akses, të kuptojnë, të kombinojnë dhe të përfitojnë nga të dhënat e hapura, për të ndihmuar organizatat dhe individët të maksimizojnë vlerën e të dhënave të hapura.

Kujdes! Organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike, duhet të vendosin një rubrikë të veçantë në faqen e tyre zyrtare për open data, të ndryshme nga Programi i Transparencës. Ky detyrim ekziston pavarësisht ekzistencës së portalit opendata.gov.al.

Të dhënat e hapura duhet të jenë të disponueshme në mënyra të ndryshme, nga vizualizimet si hartat dhe tregimet e të dhënave deri te shkarkimet e API. Mjetet e kërkimit të të dhënave duhet t'i ndihmojnë vizitorët të gjejnë lehtësisht grupet përkatëse të të dhënave për t'u përdorur.

II. HARTIMI I LISTËS

Neni 7, pika 3 parashikon detyrimin e organit të sektorit publik të përcaktojë listën e dokumenteve ekzistuese që mund të ofrohen dhe publikohen në formatin e të dhënave të hapura. Duke u vendosur në rubrikën e të dhënave të hapura, të gjitha dokumentet e listës janë të disponueshme për ripërdorim.

Identifikimi i dokumenteve përbën një nga sfidat kryesore të organit të sektorit publik. Në përmbushje të këtij detyrimi organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike duhet të kenë parasysh në hartimin e listës, **detyrat konkrete të tyre që burojnë nga legjislacioni specifik që përcakton fushën e veprimtarisë**. Detyrat e parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore materializohen në prodhimin e dokumenteve të ndryshme nga strukturat e çdo institucioni. Këto dokumente janë pjesë e Listës.

Prandaj, çdo organ duhet të kryejë një proces vlerësimi të brendshëm, bazuar në kompetencat ligjore, se çfarë të dhënash do të duhet të publikojë si të dhëna të hapura. Pavarësisht karakterit unik që ka çdo listë, mund të indentifikohen një grup dokumentesh/të dhëna që do të duhet të jenë pjesë e çdo liste të çdo organi të sektorit publik. Kjo pasi, pavarësisht kompetencave që ushtron

çdo organ (që janë unike), të gjithë organet operojnë sipas standardeve të unifikuara buxhetore, në fushën e prokurimit publik apo edhe në lidhje me përmbushjen e detyrimeve për hartimin e dokumenteve të ndryshëm politike (strategji institucionale krahas atyre ndërsektoriale, plane pune, plane veprimi etj.)

Shembull nga open data portal i Sllovenisë:

1. strategji për zhvillimin ekonomik, të qëndrueshë, rajonal, teknologjik dhe struktukturor të Republikës si dhe strategji të tjera;
2. programe për mbrojtjen e mjedisit dhe për administrimin dhe burimeve natyrore (uji, pyjet, mineralet);
3. programe zhvillimore dhe strategji zhvillimi për sektorë të ndryshëm (energji, transport, komunikimi elektronik, turizimi);
4. strategji zhvillimi për shërbime publike në fushën e energjisë, komunikimeve elektronike, menaxhimit të ujit, mbrojtjes së mjedisit, edukimin, shëndetin, kulturën);
5. strategji, programe dhe plaen të autoriteve qendrore dhe vendore, institucioneve të pavarura etj.
6. raporti vjetor dhe raporte të tjera të hartuara nga organi për periudha të gjata kohore;
7. udhëzime strategjike, prioritetet e inspektimit që rezultojnë nga plani vjetor i punës (por jo program i punës i vetë inspektorëve, apo ata që kryejnë programet e inspektimit).
8. opinione, analiza të organit që janë hartuar në kuadër të ushtrimit të kompetencave, edhe në bashkëpunim me institucione të tjera apo akte të tjera që lidhen me zbatimin e rregullores apo vendimeve të gjykatës;
9. draft akte (vendime, projektligje, udhëzime etj.) që vendosen për efekt të konsultimit public me aktorë të ndryshëm.
10. **informacion mbi shërbimet që ofron** organi që përfshin kushtet për të marrë shërbim, juridiksionin dhe aksesibiliteti i autoritetit (orari zyrtar), mënyra se si mund të kërkohet shërbimi dhe dokumentet përkatës, përmbledhje të rregullave që përbëjnë bazën ligjore për të kërkuar shërbimin
11. **informacion tjetër publik** për shembull për evente, vendime të rëndësushme apo aspekte të tjera operacionale, raport vjetor mbi zbatimin e ligjit, **informacion që më parë ka qenë objekt sipas ligjit për të drejtën e informimit dhe organi parashikon që do të ketë kërkesa të ngjashme nga kërkues të tjerë;**
12. të dhëna në lidhje me përfituesit e kredive të buta, granteve apo çdo lloj tjetër ndihme shteterore, përveç për pagesa individuale në fushën e arsimit, punës, familjes apo pensioneve apo mbështetjes sociale.
13. dokumente të prokurimit publik dhe formave të tjera të bashkëfinancimit (dokumentet e tenderit, anëtarët e komisionit, përfituesit, raport përfundimtar mbi ecurinë e tenderit).

Rekomandim: Bazuar në praktikat e mira të vendeve të BE-së, rekomandohet që në listën e të dhënave të hapura të vendosen **të paktën këto dokumente**:

(i) programe, strategji, pozicione, opinione, analiza, vendime apo dokumente të ngjashme. Këto dokumente mund të jenë edhe në version 'draft' dhe versionin përfundimtar të miratuar.
(ii) raporti vjetor i institucionit.
(iii) informacion mbi shërbimet që ofrohen.
(iv) informacion që më parë ka qenë objekt sipas ligjit për të drejtën e informimit dhe organi parashikon që do të ketë kërkesa të ngjashme nga kërkues të tjerë;

Më poshtë jepen disa shembuj të listës së të dhënave të hapura që mund të vihen në dispozicion nga organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike në sektorë të caktuar.

Organet e qeverisjes qendrore (Administrata qendrore)
1.Raporte vjetore, Vendime, Rekomandime, Statistika, Strategji, Monitorime.
2.Raportet buxhetore dhe financiare: Buxhetet vjetore, pasqyrat financiare dhe raportet e auditimit.
3.Kontratat e prokurimit: Detajet e kontratave të dhëna, duke përfshirë informacionin e shitësit, shumat e kontratës dhe kohëzgjatjen.

Sektori i Transportit
1.Oraret e transportit publik: Oraret, itineraret dhe tarifat për autobusë, trena dhe shërbime të tjera të transportit publik.
2.Të dhënat e trafikut: Përditësimet e trafikut në kohë reale, vëllimi i trafikut dhe të dhënat e shpejtësisë.
3.Të dhënat e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve: Punët e planifikuara në rrugë, mbylljet dhe aktivitetet e mirëmbajtjes.
4.Të dhënat e aksidenteve rrugore: Vendndodhjet, datat dhe kohët e aksidenteve, si dhe të dhënat e lëndimeve dhe fatalitetеve.
5.Informacion parkimi: Vendndodhja, tarifat dhe disponueshmëria e objekteve publike të parkimit.

Sektori i Infrastrukturës
1.Furnizimi me ujë të dhëna për cilësinë e ujit, disponueshmërinë, modelet e konsumit dhe infrastrukturën.
2.Rrjeti Elektrik: Raportet e ndërprerjeve, statistikat e konsumit të energjisë dhe informacioni mbi instalimet e energjisë së rinovueshme.
3.Menaxhimi i Mbetjeve: Oraret e grumbullimit, normat e riciklimit dhe të dhënat e landfillit.
4.Ndërtesat: Informacion mbi ndërtesat publike, duke përfshirë shkollat, bibliotekat dhe njësi administrative.

5.Parqe dhe Rekreacion: Vendndodhjet dhe veçoritë e parqeve, objekteve sportive dhe qendrave rekreative.

Shërbimet shëndetësore dhe sociale

1.Vendndodhjet e spitaleve dhe objekteve të kujdesit shëndetësor: Adresat, numrat e telefonit dhe shërbimet e ofruara.
2.Statistikat e kujdesit shëndetësor: Të dhëna mbi shpërthimet e sëmundjeve, vaksinimet dhe tendencat shëndetësore.
3.Informacioni i programit të shërbimit social: Kriteret e përshtatshmërisë, proceset e aplikimit dhe detajet e programit.
4.Të dhënat e inspektimit të sigurisë ushqimore: Rezultatet e inspektimeve të restoranteve dhe objekteve ushqimore.
5.Të dhënat e shëndetit mendor dhe abuzimit me substancat: Lista e shërbimeve të disponueshme, grupeve mbështetëse dhe linjave telefonike.

Sektori i arsimit

1.Kufijtë dhe hartat e shkollave: Informacion gjeografik mbi zonat e vendndodhjes së shkollës.
2.Të dhënat e performancës së shkollës: Rezultatet e testeve, normat e diplomimit dhe të dhëna të tjera.
3.Informacioni për kurrikulën dhe degët: Detaje mbi degët e ofruara, duke përfshirë përshkrimet dhe kushtet paraprake.
4.Regjistrimi i studentëve dhe të dhënat demografike: Statistikat e popullsisë së studentëve, duke përfshirë moshën, gjininë dhe të dhënat socio-ekonomike.
5.Katalogu i bibliotekave dhe të dhënat e vendndodhjes: Lista e librave, mediave dhe burimeve të tjera të disponueshme në biblioteka.

Siguria Publike

1.Statistikat dhe hartat e krimit: Të dhëna për llojet, vendndodhjet dhe shpeshtësinë e krimeve.
2.Të dhënat e reagimit emergjent: Kohët e reagimit, llojet e incidentit dhe të dhënat e vendndodhjes.
3.Vendndodhjet dhe aparatet e stacioneve të zjarrfikëses: Adresat, numrat e telefonit dhe informacionet e pajisjeve.
4. Raportet e policisë dhe departamentit të zjarrfikëseve: Raportet e incidentit, të dhënat e arrestimit dhe dokumente të tjera të sigurisë publike.
5. Planet e gatishmërisë dhe reagimit ndaj fatkeqësive Informacion mbi procedurat e emergjencës, rrugët e evakuimit etj.

Mjedisi

1.Të dhënat e cilësisë së ajrit dhe ujit: Rezultatet e monitorimit, duke përfshirë nivelet dhe tejkalimet e ndotësve.
2.Informacion për parqet dhe zonat e rekreacionit, Vendndodhjet, komoditetet dhe orët e funksionimit.
3.Detajet e programit të riciklimit: Materialet e pranuara, oraret e grumbullimit dhe vendet e shkarkimit.
4.Të dhënat e menaxhimit të mbetjeve: kapaciteti i landfillit, shkalla e gjenerimit të mbetjeve dhe metodat e depozitimit.
5.Kufijtë dhe shtigjet e zonave të ruajtjes: Harta dhe informacione mbi zonat e mbrojtura, duke përfshirë shtigjet e ecjes dhe biçikletës.

Zhvillimi ekonomik
1.Të dhënat për licencat dhe lejeve të biznesit: Listimet e bizneseve të licencuara, duke përfshirë pronarët dhe informacionin e kontaktit.
2.Treguesit ekonomikë: Normat e papunësisë, PBB dhe tregues të tjerë ekonomikë.
3.Informacioni për tregun e punës: Hapjet e vendeve të punës, të dhënat e pagave dhe tendencat e punësimit.
4.Programet e nxitjes tatimore: Detaje mbi stimujt në dispozicion, kriteret e përshtatshmërisë dhe proceset e aplikimit.
5.Listat e pronave për biznes: Pronat e disponueshme, duke përfshirë vendndodhjet, madhësitë dhe çmimet.

Të tjera:
1.Të dhënat GIS: Informacion gjeohapësinor mbi infrastrukturën, kufijtë dhe veçori të tjera.
2.Të dhënat e motit: Kushtet aktuale të motit, parashikimet dhe të dhënat historike të klimës.
3.Kalendarët e ngjarjeve kulturore: Listimet e koncerteve, festivaleve dhe ngjarjeve të tjera.
4.Koleksionet e muzeut dhe galerisë: Koleksione dhe ekspozita në internet.

Lista e përmendur më sipër ka karakter orientues dhe si e tillë nuk është dhe nuk duhet të konsiderohet shteruese. Çdo organ duhet të vlerësojë dokumentet e tjera që do të duhet të shtohen.

III. DETYRIMI PËR PUBLIKIM/PËRDITËSIM

Detyrimi për publikim i të dhënave të hapura, nënkupton edhe detyrimin për përditësim të herë pas hershëm. Nisur nga numri i lartë i organeve të sektorit publik dhe sipërmarrjeve publike është e pamundur të vendosen afate fikse që mund të zbatohen nga secili prej tyre. Prandaj, mbetet në diskrecionin e organit dhe sipërmarrjes frekuenca e publikimit dhe përditësimit. Në parim, e dhëna duhet përditësuar menjëherë sapo organi apo sipërmarrja ka krijuar/hartuar një të dhënë më të freskët dhe që i korrespondon aktualitetit të zhvillimeve dhe zbatimit të ligjit. Kjo mund të përbëjë një sfidë për ato organe që referuar kompetencave të tyre, marrin vendime që ndryshojnë të dhënat me një frekuencë ditore, javore apo mujore.

Paralelisht me përcaktimin e listës së dokumenteve ekzistuese që mund të ofrohen në formatin e të dhënave të hapura, organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike, kanë detyrimin ta publikojnë atë.

Në këtë kuptim, organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike inkurajohen që në faqen e tyre zyrtare të internetit (website), në menunë e webfaqes ose në një seksion të dukshëm të kryefaqes, të krijohet mundësia e aksesit të një rubrike të dedikuar për funksionin open data.



Pas aksesimit në këtë rubrikë, do të shfaqet lista e publikuar e dokumenteve që ofrohen në formatin e të dhënave të hapura, shoqëruar edhe nga licenca përkatëse për këto dokumente.

Pasi klikojmë në një nga dokumentet e listës, duhet të shfaqet informacioni i kërkuar në formatin e të dhënave të hapura.



Në rast se çdo përdorues, ka nevojë për më tepër informacion rreth këtij dokumenti, apo dokumentin zyrtar ekzistues, të bërë publik më herët nga organi i sektorit publik apo sipërmarrja publike në format të ndryshëm nga ai i të dhënave të hapura, mund ta konsultojë atë lehtësisht duke klikuar në hapin e katërt që të dërgon automatikisht nëpërmjet hiperlinkut në materialin e kërkuar.

Nga ana tjetër, sikundër është sipërcituar, me qëllim lehtësimin e kërkimit të të dhënave të hapura të ofruara nga organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike, funksionon portali i të dhënave të hapura qeveritare opendata.gov.al (https://opendata.gov.al/). Në këtë kuadër, organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike, paralelisht me publikimin e dokumenteve që ofrohen në formatin e të dhënave të hapura në menunë e faqes zyrtare të institucionit, do të duhet të bëjnë publikimin e tyre edhe në portalin e të dhënave të hapura qeveritare.



IV. FORMATET/LICENCA

Publikimi i të dhënave të hapura dhe ripërdorimi i nënshtrohen rregullave të përputhshmërisë teknike lidhur me formatet dhe licencat. Kështu, në nenin 6, pika 6 e ligjit nr. 33/2022 është përfshirë përkufizimi i termit "Licencë standarde".[21] Më tej, neni 11 rregullon përdorimin e licencës standarde, ndërsa neni 9 parashikon formatin e dokumentave. Të gjitha këto dispozita janë

[21] Kuptohet tërësia e kushteve të ripërdorimit të paracaktuara në një format digjital që i bëhen të njohura aplikantit në momentin e kërkesës për ripërdorim.

të lidhura me njëra-tjetrën dhe plotësojnë tabllonë mbi mënyrën/formatin se si bëhet publikimi i të dhënave të hapura me qëllim ripërdorimi dhe cilat janë mjetet që garantojnë integritetin e burimit.

Licencat standarde kanë të bëjnë me formate të paracaktuara ligjore. Këto formate përcaktojnë kushtet, të drejtat dhe kufizimet e ripërdorimit të dokumenteve si: për printimin, kopjimin, përpunimin e të dhënave, lejimin ose jo të transferimit tek palët e treta, kërkesat për respektimin e pronësisë intelektuale, dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Qëllimi i licencës së të dhënave të hapura të organeve të sektorit publik dhe sipërmarrjeve publike, është të ofrojë siguri juridike që të dhënat që janë objekt i licencës mund të përdoren lirisht nga të gjithë në çdo mënyrë të mundshme, me kushtin kryesor që burimi i të dhënave të përmendet në mënyrën që kërkohet në licencë.

Me anë të Udhëzimit të përbashkët nr. 2, datë 6.2.2025 *"Për miratimin e licencës standarde të ripërdorimit të informacionit të sektorit publik",* të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit [22] janë miratuar modelet e formatit elektronik të licensave standarde, të cilat do të përdoren nga organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike për të shoqëruar të dhënat e hapura të publikuara prej tyre sipas specifikave përkatëse të dokumentit.

Tabela më poshtë ilustron kategoritë e licencave.

Nr.	Emri i licencës	Përshkrimi	Elementët e licencës	Logo
Licenca nr. 1	Atributi duhet t'i jepet krijuesit.	Kjo licencë u mundëson ripërdoruesve të shpërndajnë, ripërziejnë, adaptojnë dhe ndërtojnë mbi materialin në çdo formë apo format, për aq kohë sa atributi i jepet krijuesit. Licenca lejon përdorimin komercial.	CC BY	

[22] Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 29

Licenca nr. 2	Atributi duhet t'i jepet krijuesit dhe përshtatjet duhet të ndahen sipas të njëjtave kushte.	Kjo licencë u mundëson ripërdoruesve të shpërndajnë, ripërziejnë, adaptojnë dhe ndërtojnë mbi materialin me çdo mjet apo format, për aq kohë sa atributi i jepet krijuesit. Licenca lejon përdorimin komercial. Nëse remixoni, adaptoni ose ndërtoni mbi materialin, duhet të licenconi materialin e modifikuar sipas termave identikë.	CC BY-SA	
Licenca nr. 3	Atributi duhet t'i jepet krijuesit dhe lejohen vetëm përdorimet jokomerciale të veprës.	Kjo licencë u mundëson ripërdoruesve të shpërndajnë, ripërziejnë, adaptojnë dhe ndërtojnë mbi materialin në çdo formë ose format vetëm për qëllime jokomerciale, dhe vetëm për aq kohë sa atributi i jepet krijuesit.	CC BY-NC	
Licenca nr. 4	Atributi duhet t'i jepet krijuesit. Lejohen vetëm përdorimet jokomerciale të veprës. Përshtatjet duhet të ndahen sipas të njëjtave kushte.	Kjo licencë u mundëson ripërdoruesve të shpërndajnë, ripërziejnë, adaptojnë dhe ndërtojnë mbi materialin në çdo formë ose format vetëm për qëllime jokomerciale, dhe vetëm për aq kohë sa atributi i jepet krijuesit. Nëse remixoni, adaptoni ose ndërtoni mbi materialin, duhet të licenconi materialin e modifikuar sipas termave identikë.	CC BY-NC-SA	

Licenca nr. 5	Atributi duhet t'i jepet krijuesit. Nuk lejohet asnjë derivat apo përshtatje e veprës.	Kjo licencë u mundëson ripërdoruesve të kopjojnë dhe shpërndajnë materialin në çdo formë apo format vetëm në formë të paadaptuar, dhe vetëm për aq kohë sa atributi i jepet krijuesit. Licenca lejon përdorimin komercial.	CC BY-ND	
Licenca nr. 6	Atributi duhet t'i jepet krijuesit. Lejohen vetëm përdorimet jokomerciale të veprës. Nuk lejohet asnjë derivat apo përshtatje e veprës.	Kjo licencë u mundëson ripërdoruesve të kopjojnë dhe shpërndajnë materialin në çdo formë apo format në formë të paadaptuar vetëm, vetëm për qëllime jokomerciale, dhe vetëm për aq kohë sa atributi i jepet krijuesit.	CC BY-NC-ND	
Licenca nr. 7	Dedikimi i domenit publik.	Kjo licencë është një mjet dedikimi publik, i cili u mundëson krijuesve të heqin dorë nga e drejta e autorit dhe t'i fusin veprat e tyre në domenin publik mbarëbotëror. CC0 u jep mundësi ripërdoruesve të shpërndajnë, ripërziejnë, adaptojnë dhe ndërtojnë mbi materialin në çfarëdo forme apo formati, pa kushte.	CC0	

Në tabelën më poshtë shpjegohen rastet kur përdoret licenca përkatëse:

	Për shembul regjistri publik me adresat apo për dokumente historike apo punime/të dhëna me karakter të gjerë publik, për shembull **The Rijksmuseum (CC0 for digitized art**

	collections) apo NASA's Open Source Softëare (CC0 for datasets and images).
	Si kjo licencë ashtu edhe ajo më sipër (Public Domain) mund të përdoren pa asnjë kufizim. Të drejtat e autorit përfundojnë pas 70 viteve dhe prej atij momenti konsiderohet e mirë e përmbashkët. Këtu mund të përmendim, çdo lloj veprimtarie letrare që përban emrin e autorit, pas përfundimit të periudhës 70 vjeçare.
	Për të gjitha llojet e të dhënave/informacioneve që hartohen nga organet e sektorit publik/sipërmarrjet publike, përmbajtja vihet në dispozicion nëpërmjet kësaj licence. Për shembull shiko faqen zyrtare të KDIMDP. Kjo është licenca më e përdorur nga institucionet/organet edhe në vendet e BE-së, si dhe **European Union Open Data Portal (CC BY 4.0)**. Kjo licencë siguron përdorim të hapur, përshtatje dhe shpërndarje për sa kohë ruhen të dhërat e burimit. Së bashku me **CC0 (Public Domain Dedication)** që lejon shpërndarjen e informacionit pa asnjë kufizim duke maksimizuar aksesin, këto dy licenca janë më të përdorurat.
	Këto tre licenca lidhen me arsimin ose punën kërkimore shkencore dhe ata përcaktojnë nëse do të lejojnë përdorues të lexojnë vetëm dokumentin pa i akorduar të drejta të tjera në lidhje me këtë tekst. Psh. Si në rastin e "Croatian Scientific Bibliography CROSBI" **https://www.croris.hr/crosbi/?lang=en** apo në rastet e databazave të vendimeve gjyqsore apo edhe institucionet e arsimit të lartë si **MIT OpenCourseWare (CC BY-NC-SA 4.0)**. Një shembull tjetër është **World Bank Open Knowledge Repository (CC BY 3.0 IGO)** që kufizon ripërdorimin tregtar por lejon atë për arsye edukimi apo kërkimi shkencor si raporte, sondazhe, rekomandime apo të dhëna mjedisore.

V. TARIFA

Edhe pse Direktiva dhe Ligji parashikojnë se, si rregull, informacioni i sektorit publik vihet në dispozicion për ripërdorim pa pagesë, mund të ketë raste kur aplikohet pagesë. Ligji ka parashikuar se çfarë mbulon kosto shtesë që lidhen me riprodhimin, ofrimit e shpërndarjes së dokumenteve, për anonimizimin e të dhënave personale, si dhe për masat e marra për të mbrojtur informacionin sekret tregtar (neni 10, pika 2).

Shembull: Kostot sipas kuadrit ligjor në Mal të Zi përfshijnë:

1. Kostot e riprodhimit që përfshin ato të printimit, digjitalizimit të dokumentit, si dhe materialet apo pajisjet e përdorura për riprodhimin.
2. Kostot e shpërndarjes së dokumenteve përfshin koston e transportit, ato postare apo të transmetimit elektronik tek kërkuesi.
3. Kostot e anonimizimit nënkuptojnë kostot e heqjes së informacionit personal apo konfidencial nga dokumenti siç është emër/mbiemër, adresa apo të dhëna sensitive.
4. Kostot për të mbrojtur sekretin tregtar nënkuptojnë kostot për heqjen apo redaktimin e informacionit sensitiv nga document si sekreti tregtar apo informacion tjetër konfidencial i biznesit.
5. Kosto të personelit nënkupton kohën e shpenzuar nga stafi për riprodhimin, shpërndarjen, anonimizimin dhe mbrojtjen e dokumentit.
6. Kostot e përgjithshme nënkuptojnë kostot e tjera si për infrastrukturën (zyrën) shërbimet utilitare apo amortizimi i pajisjeve.
7. Kostot administrative nënkuptojnë ato që lidhen me procesimin e kërkesës, inventarizimi apo edhe gjurmimi.
8. Kostot e oportunitetit nënkupton vlerën e kohës së shpenzuar nga stafi që mund të ishte shpenzuar për detyra të tjera të organit.

Një nga rastet ku si Direktiva ashtu edhe Ligji bën përjashtim nga ofrimi pa pagesë, duke hapur kështu rrugën për aplikimin e një tarife janë bibliotekat, përfshirë bibliotekat universitare, muzetë dhe arkivat (shkronja b), pika 3). Kjo kategori mund të aplikojë tarifa që shkojnë edhe përtej kostove shtesë të përmendura në pikën 2 por që kanë lidhje me mënyrën se si operojnë kjo kategori institucionesh. Tarifa mund të jetë e tillë që mbulon edhe pjesën e 'rikthimit të investimit'.
Një kategori tjetër që ligj lejon aplikimin e tarifës janë organet e sektorit publik, të cilat, sipas legjislacionit të posaçëm për funksionimin e tyre, sigurojnë të ardhura për të mbuluar një pjesë të konsiderueshme të kostove që lidhen me kryerjen e detyrave të tyre publike (shkronja a) dhe sipërmarrjet publike (shkronja c).

Për çdo rast ku aplikohet tarifa, metodologjia, masa dhe përdorimi i tarifës duhet të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Organi i sektorit publik që aplikon tarifa për të drejtën e ripërdorimit e bën atë publike në faqen e vet të internetit, si dhe në portalin unik qeveritar të të dhënave të hapura.
Nga pikëpamja metodologjike ka disa metoda që mund të zbatohen për llogaritjen e kostove të ripërdorimit që përfshin kostot direkte, indirekte, kostot oportune, ato margjinale, dhe ato mesatare. Kosto apo tarifa vjen si rezultat i disa faktorëve si për shembull volumi i kërkesave, kompleksiteti, frekuenca dhe lloji/natyra e të dhënave që kërkohen.

Vlen të theksohet që tarifa duhet të jetë e arsyeshme dhe nuk duhet të përdoret apo shërbejë si barrierë për të mosaksesuar apo mosdisponuar të dhënën/informacionin. Të ardhurat që mund të përfitohen nga ripërdorimi nuk duhet të tejkalojnë kostot e mbledhjes, prodhimit, riprodhimit, shpërndarjes dhe ruajtjes së të dhënave. Kjo pasi aksesi në informacion duhet të qëndrojë në balancë të drejtë dhe të përballueshme.

E. E DREJTA PËR RIPËRDORIM

Termi “ripërdorim” përfshin disa parime dhe aspekte kryesore:

1. “Disponueshmëria Publike”: Të dhënat e hapura bëhen lirisht të aksesueshme për publikun, shpesh përmes burimeve qeveritare ose institucionale. Kjo do të thotë që çdokush mund të aksesojë, përdorë dhe rishpërndajë të dhënat pa u përballur me kufizime ligjore ose tarifa të tepërta.
2. “Ndërveprueshmëri dhe standardizim”: Të dhënat e hapura duhet të publikohen në formate standarde që lehtësojnë ndërveprimin, duke e bërë më të lehtë kombinimin e grupeve të të dhënave nga burime të ndryshme ose përdorimin e mjeteve dhe algoritmeve që përpunojnë të dhënat.
3. “Licencimi”: Të dhënat e hapura duhet të shoqërohen me informacion të qartë licencimi që specifikon se si mund të përdoren. Shumë grupe të dhënash shoqërohen me licenca që lejojnë ripërdorimin me atribuimin e duhur në burimin origjinal.
4. “Inkurajimi i Inovacionit”: Ripërdorimi i të dhënave të hapura mund të çojë në zhvillimin e aplikacioneve, shërbimeve ose njohurive të reja, duke nxitur inovacionin në fusha të ndryshme, si shkenca, teknologjia, politika sociale dhe biznesi.
5. “Transparenca dhe Përgjegjshmëria”: Ripërdorimi i të dhënave të hapura rrit transparencën dhe llogaridhënien, veçanërisht në kontekstet e qeverisë dhe sektorit publik, pasi u mundëson qytetarëve dhe studiuesve të analizojnë dhe vlerësojnë veprimet e institucioneve publike.
6. “Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i njohurive”: Ripërdorimi i të dhënave të hapura inkurajon bashkëpunimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë studiuesit, zhvilluesit dhe politikëbërësit, për të shfrytëzuar njohuritë që rrjedhin nga të dhënat.

I. KËRKESA DREJTUAR ORGANIT

Sa më shumë dokumente janë të disponueshme në rubrikën të dhëna të hapura, aq më shumë dokumente janë në dispozicion për ripërdorim nga aktorët e ekosistemit. Kur dokumentet janë vendosur në rubrikën të dhëna të hapura, organi i sektorit publik apo sipërmarrja publike i vë në dispozicion për ripërdorim, pavarësisht se këto dokumente mund të jenë gjithashtu objekt i Ligjit për të drejtën e informimit apo edhe pjesë e Programit të Transparencës. Sipas Ligjit të dhënat publike dhe të dhënat që përftohen nëpërmjet fondeve publike duhet **të jenë të përdorshme për qëllime tregtare dhe jo-tregtare** (*neni 7, pika 1*).

Kur informacioni i sektorit publik që bie në fushëveprimin e Ligjit nr. 33/2022, nuk publikohet në mënyrë *proaktive* si të dhëna të hapura, ai duhet gjithsesi të vihet në dispozicion për ripërdorim, në formatin elektronik, kur është e mundur, pas një kërkese për ripërdorim të paraqitur nga një ripërdorues (*neni 8*). Kërkesa që do të paraqitet duhet të përmbajë elementët e nevojshëm sipas modelit të Aneksit 3, që mund të përdoret si shembull dhe udhëzues për kërkesën tuaj për ripërdorim drejtuar organit të sektorit publik.

Trajtimi i kërkesave për ripërdorimin e të dhënave të hapura nga organet e sektorit publik, zakonisht përfshin disa hapa dhe procedura. Ndërsa proceset specifike mund të ndryshojnë sipas juridiksionit dhe institucionit. Më poshtë janë disa praktika të zakonshme.

1. “Politikat e të dhënave të hapura”: Organet e sektorit publik kanë krijuar politika që përshkruajnë se si mund të aksesohen dhe ripërdoren të dhënat e hapura. Këto politika sqarojnë llojet e të dhënave të disponueshme, të drejtat e përdorimit dhe çdo kufizim.
2. “Lista e të dhënave të hapura”: Organet e sektorit publik shpesh mbajnë një listë ose rubrikë të dhënash ku publikohen të dhënat e hapura. Përdoruesit mund të shfletojnë, apo kërkojnë të dhëna direkt nga kjo listë.
3. “Dorëzimi i kërkesës”: Nëse të dhënat nuk janë të disponueshme në website, një individ ose organizatë mund të paraqesë një kërkesë zyrtare për ripërdorim për grupe specifike të dhënash. Kjo kërkesë zakonisht mund të bëhet përmes një formulari në internet, me email, personalisht ose me postë.
4. “Vlerësimi i Kërkesave”: Organi i sektorit publik vlerëson kërkesën për të përcaktuar nëse të dhënat mund të publikohen. Kjo mund të përfshijë kontrollin nëse të dhënat janë të ndjeshme, nëse i nënshtrohen kufizimeve të privatësisë ose nëse kërkojnë përpunim shtesë.
5. “Përgatitja e të dhënave”: Nëse kërkesa miratohet, të dhënat mund të kenë nevojë të pastrohen, anonimizohen ose formatohen siç duhet përpara se t'i jepen kërkuesit.
6. “Licencimi”: Organet e sektorit publik ofrojnë informacion mbi licencimin e të dhënave që lejojnë ripërdorimin, me kusht që të jepet atributi (të tregohet burimi), ndërsa në raste të tjera mund të kenë kushte specifike në varësi të specifikave të dokumentacionit.

7. “Sigurimi i aksesit”: Pasi të dhënat të jenë gati, organi i sektorit publik i ofron akses kërkuesit.
8. “Monitorimi dhe Pajtueshmëria”: Organet e sektorit publik mund të monitorojnë përdorimin e të dhënave për të siguruar të dhëna raportimi dhe të ofrojnë mbështetje dhe t'i përgjigjen çdo pyetjeje në lidhje me të dhënat.
9. “Feedback dhe përmirësim”: Organet e sektorit publik mund të inkurajojnë reagimet nga përdoruesit për të përmirësuar cilësinë dhe aksesin e të dhënave, duke çuar në përmirësime në ofimin e të dhënave të hapura.
10. “Bashkëpunimi me Përdoruesit”: Organet e sektorit publik duhet të nxisin bashkëpunimin me përdoruesit, duke përfshirë studiues, zhvillues dhe biznese, për të lehtësuar përdorimin inovativ të të dhënave dhe për të përmirësuar rëndësinë e tyre.

Me ndjekjen e këtyre hapave, organet e sektorit publik mund të trajtojnë në mënyrë efektive kërkesat për ripërdorimin e të dhënave të hapura, duke promovuar transparencën dhe angazhimin dhe njëkohësisht duke ruajtur privatësinë dhe kufizimet ligjore. Për të krijuar në mënyrë efektive një kërkesë për ripërdorim të të dhënave të hapura, është e rëndësishme të jepni një përshkrim të qartë të qëllimeve tuaja, llojit të të dhënave për të cilat jeni të interesuar dhe se si planifikoni t'i përdorni ato.

Organet e sektorit publik (me përjashtim të sipërmarrjeve publike, institucioneve arsimore, organizatave që kryejnë kërkime dhe organizatave të financimit të kërkimit) duhet t'i përgjigjen kërkesës brenda një afati të arsyeshëm, por jo më vonë se 15 ditë pune nga dorëzimi i kërkesës. Ky afat mund të zgjatet me jo më shumë se 20 ditë pune në rast të kërkesave voluminoze apo të ndërlikuara duke njoftuar kërkuesin për zgjatjen e afatit.

Organet e sektorit publik nuk kanë detyrimin për të dhënë një ekstrakt nga një dokument apo për të modifikuar formatin e informacionit të kërkuar kur kjo përfshin një përpjekje jo proporcionale), duke shkuar përtej funskionit të zakonshëm. (*neni 7 pika 4).* Kushtet për ripërdorim duhet të jenë jo diskriminuese për kategoritë e krahasueshme të ripërdorimit. Kjo nuk përjashton, për shembull, se kostoja e marrjes së një grupi të dhënash për një përdorim tregtar është e ndryshme nga ajo për një përdorim jo-tregtar.

Grupet e të dhënave me vlerë të madhe janë subjekt i një sërë rregullash shtesë (*neni 17*). Ato duhet të vihen në dispozicion për ripërdorim:

- falas;
- në kushtet e një licence të hapur ose sa më pak kufizuese;

- në një format të njohur të hapur, të lexueshëm nga makineritë;
- nëpërmjet ndërfaqeve të programimit të aplikacioneve (API) dhe shkarkimit me shumicë;
- në versionin e tyre më të përditësuar dhe kur është me rëndësi të ofruara si një shkarkim i vetëm.

Organi i sektorit publik duhet të sigurojë që metadatat shoqëruese të identifikojnë qartë dataset me vlerë të madhe si të tilla, në mënyrë që t'i bëjnë ato të gjetshme.

Nëse refuzohet një kërkesë, organi i sektorit publik duhet të shpjegojë dhe justifikojë vendimin.

II. ARSYET E REFUZIMIT

Kërkesa duhet të plotësojë ndër të tjera edhe kushtin që të arsyetojë qartë qëllimin e ripërdorimit, llojin e të dhënave për të cilat personi është i interesuar dhe se si planifikohet të përdoren. Fakti që kërkohet parashtrim argumentues nuk përbën barrierë për të marrë informacionin. Organi duhet të jetë i qartë se përse po investon burime të brendshme në funksion të vënies në dispozicion të informacionit/të dhënës dhe se nuk jemi përpara një rasti haptazi abuziv dhe të paarsyetuar.

Më poshtë disa shembuj që mund të ndiqen nga organet e sektorit publik në rast të refuzimit të kërkesës për ripërdorim.

Rasti 1: Informacion konficencial statistikor

Në procedurën sipas kërkesës për ripërdorim, nr____ datë_____, paraqitur nga (emri dhe mbiemri/emri i aplikantit), _____ (emri i organit të sektorit publik) ka konstatuar se posedon informacionin e kërkuar. Pas shqyrtimit të përmbajtjes së informacionit të kërkuar, _____ (emri i organit të sektorit publik) përcaktoi se ai përmban informacione konfidenciale statistikore, në përputhje me Ligjin që rregullon statistikat zyrtare. Bazuar në nenin 4, pika ç/ii e Ligjit nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik", organi i sektorit publik do të refuzojë kërkesën për ripërdorim të informacionit, nëse objekt i ripërdorimit është informacioni konfidencial statistikor, në pajtim me Ligjin që rregullon statistikat zyrtare, kështu që kërkesa për ripërdorim të informacionit duhet të kufizohet.

Kërkesa për ripërdorimin e informacionit paraqitur nga (emri dhe mbiemri/emri i aplikantit) numër:___ (datë)_____, me të cilën aplikanti ka kërkuar ripërdorimin _____ (përshkrimi i informacionit të kërkuar nga aplikanti) refuzohet si e pabazuar.

Rasti 2: Krijimi i informacionit të ri

Kërkesa për ripërdorimin e informacionit _____ (emri dhe mbiemri/emri i aplikantit) numër: ____ e _____ (data) me anë të së cilës ka kërkuar ripërdorimin e _____ (përshkrimi i informacionit të kërkuar) refuzohet si e pabazuar. Ligji nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektkosorit publik", përcakton se një dokument është: pjesë e një dokumenti në formë të shkruar, të shtypur, video, audio, elektronike ose në ndonjë formë tjetër, duke përfshirë kopjet e tij, pavarësisht nga përmbajtja, burimi (autori), koha e krijimit ose sistemi i klasifikimit.

Organi refuzon kërkesën për ripërdorimin e informacionit nëse veprimi mbi kërkesën nënkupton ose kërkon detyrimin për të krijuar informacion të ri, për ta përshtatur ose për të nxjerrë një pjesë të informacionit. Pas shqyrtimit të përmbajtjes së kërkesës së dorëzuar është e qartë se aplikanti kërkon që organi qeveritar të krijojë informacion që nuk përfaqëson informacion në kuptimin të Ligjit nr.33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik".

Rasti 3: Ekzistenca e interesit ligjor

Sipas Ligjit nr.33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik" organi refuzon kërkesën për ripërdorimin e informacionit nëse për të pasur qasje në atë informacion, kërkuesi duhet të dëshmojë ekzistencën e një interesi ligjor të veçantë për objektin e ripërdorimit.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës, _____ (emri i organit) konstatoi se është në posedim të informacionit të kërkuar. Referuar kërkesës, kërkuesi nuk dëshmoj/vërtetoj ekzistencën e një interesi juridik të veçantë për objektin e ripërdorimit.

Rasti 4: Informacioni nuk është krijuar brenda fushës së veprimtarisë së organit nga i cili kërkohet

Sipas Ligjit nr.33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik", organi mund të refuzojë kërkesën për ripërdorimin e informacionit nëse informacioni nuk është krijuar brenda fushës së veprimtarisë së autoritetit nga i cili kërkohet informacioni.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës, u konstatua se organi është në posedim të informacionit të kërkuar. Referuar përmbajtjes së informacionit të kërkuar, rezulton se informacioni që është objekt i ripërdorimit nuk është krijuar brenda fushës së veprimtarisë së këtij organi.

III. ANKESA

Nëse një aplikant dëshiron të kundërshtojë vendimin (p.sh. me arsyetimin se të dhënat duhet të vihen në dispozicion si të dhëna të hapura), vendimi mund të ankimohet pranë Zyrës së Komisionerit (neni 20) dhe vendimi i Komisionerit mund të ankimohet në gjykatë (neni 21). Organi i sektorit publik, pasi ka shqyrtuar kërkesën sipas afateve ligjore, i cili refuzon një kërkesë për ripërdorim, informon kërkuesin me shkrim lidhur me arsyet e refuzimit. Në vijim, bazuar në nenin 20 të ligjit, parashikohet procedura për shqyrtimin e ankesave.

Për orientim dhe lehtësi të kryerjes së ankimit të çdo qytetari për sa më sipër, mund të përdoret Formulari i Ankesës sipas Aneksit 4. Ky formular mund të dërgohet elektronikisht ose me postë zyrtare në adresë të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Procedura që kryen Komisioneri

Me paraqitjen e ankesës pranë Zyrës së Komisionerit, struktura përgjegjëse duhet të zhvillojë procedurën administrative, bazuar në ligjin nr. 33/2022, Kodin e Procedurave Administrative dhe aktet e brendshme të Zyrës së Komisionerit.

- *Verifikon anën formale të ankesës, mënyrën e depozitimit të saj, gjeneralitetet e ankuesit, nëse është objekt i ligjit nr.33/2022 si dhe afatin e përcaktuar në pikën 2 të nenit 20 të ligjit nr.33/2022.*
- *Në vijim, Zyra e Komisionerit, referuar parashikimeve të KPA mund t'i kërkojë ankuesit dhe Organit të Sektorit Publik kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim, mbi objektin e ankesës me qëllim kryerjen e një procedure administrative sa më të plotë në procesin e hetimit administrativ, i cili ndikon ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimit përfundimtar të Komisionerit.*

Ky proces mund të konsiderohet edhe si një procedurë e ndërmjetme dhe të ndihmojë në zgjidhjen e objektit të ankesës, duke sjellë përfundimin e procedurës administrative.

- Në vijim, Komisioneri në kuadër të një hetimi të plotë mund të vendosë:

  - ✓ *Inspektim pranë Organit te Sektorit Publik/Sipërmarrjes Publike;*
  - ✓ *Seancë dëgjimore me praninë e palëve (Organit të Sektorit Publik dhe palës ankuese).*

- Në rastin e inspektimit, brenda afatit të përcaktuar në urdhrin e inspektimit, Grupi i punës paraqitet në ambientet e organit të sektorit publik/sipërmarrjes publike dhe kontakton personin(at) e autorizuar për të përfaqësuar organin në këtë proces dhe tregon në mënyrë të

përmbledhur shkakun e hetimit dhe kur është e nevojshme dhe argumentimin ligjor të këtij shkaku e kërkohet sqarim nga personat përgjegjës.
I gjithë procesi duhet të dokumentohet në procesverbal, i cili mbahet ndërmjet përfaqësuesve të Zyrës së Komisionerit dhe përfaqësuesve të organit të sektorit publik.

- Grupi i inspektimit i paraqet Komisionerit një Relacionin mbi hetimin e kryer për veprime të mëtejshme. Komisioneri në vlerësim të rrethanave dhe ecurisë së veprimeve mund të vendosë:

  - Zhvillimin e një seance dëgjimore
  - Marrjen e Vendimit përfundimtar

Komisioneri, mund ta konsiderojë të përmbushur detyrimin për të dëgjuar palët, nëse konsideron se ato e kanë pasur mundësinë që gjatë gjithë procedurës administrative të shprehin qendrimin e tyre.
Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri, bazuar në nenin 20 të ligjit nr. 33/2022, brenda afatit 30 (tridhjetë) ditë pune (duke parashikuar dhe pezullimin e afateve proceduriale për njoftimet e kryera apo zhvillimin e inspektimeve dhe seancave dëgjimore, referuar parashikimeve të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"), mund të vendosë:

a) mospranimin e ankesës,

b) pranimin e ankesës dhe

c) rrëzimin e ankesës.

ç) afatin brenda të cilit organi i sektorit publik ose sipërmarrja publike duhet të zbatojë urdhrin.

Rastet e Vendimmarrjes së Komisionerit

a) Mospranimi i ankesës është një vendimmarrje procedurale. Në këtë rast, Komisioneri merr vendim të mos e shqyrtojë atë në themel, pasi ankesa për shkaqe procedurale nuk është e pranueshme. Këto shkaqe janë:
   i) ka kaluar afati i parashikuar nga ligji (neni 20 pika 2);
   ii) ankimi nuk paraqitet në formë shkresore;
   iii) nuk tregohet emri dhe adresa e ankuesit.

b) Pranimi i ankesës, ndodh në rastin kur Komisioneri e ka shqyrtuar në themel ankesën dhe e ka konsideruar atë të bazuar. Në këtë rast Komisioneri urdhëron organin e sektorit publik për të vënë në dispozicion dokumentin e kërkuar për ripërdorim në mënyrë të plotë ose të

pjesshme. Në këtë rast, Komisioneri ka të drejtë që të përcaktojë edhe afatin, brenda të cilit OSP duhet të zbatojë urdhrin.

c) Rrëzimi i ankesës, pjesërisht ose tërësisht. Rrëzimi tërësor ndodh nëse ankesa është e pabazuar dhe autoriteti publik ka qenë i justifikuar në mosdhënien e informacionit të kërkuar. Rrëzimi i pjesshëm ndodh në rastin kur dokumentacioni për ripërdorim mund të jepet në mënyrë të pjesshme, ndërsa një pjesë e tij nuk mund të jepet bazuar në kufizimet që parashikon ligji nr. 33/2022, neni 4. Në këtë rast kemi pranim të pjessëshm të ankesës.

Të gjitha palët e prekura nga vendimi i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale kanë të drejtën të ankimojnë këtë vendim në gjykatën administrative të shkallës së parë Tiranë.

Ë. MBIKËQYRJA E ORGANEVE TË SEKTORIT PUBLIK DHE SIPËRMARRJEVE PUBLIKE

I. PARIMET

Mbikëqyrja do të udhëhiqet nga parimet e Direktivës sipas të cilës të dhënat duhet të jenë '*open by design and by default*' si dhe '*as open as possible, as closed as necessary'* si dhe parimet FAIR të përmendura më sipër. Në të njëjtën kohë mbikqyrja do të kryehet edhe në përputhje me parimet e Kodit të Procedurës Administrative (nenet 9-20).

II. PROCEDURA E MBIKËQYRJES

Mbikëqyrja e organeve të sektorit publik dhe sipërmarrjeve publike, në kuadër të Ligjit nr. 33/2022, mbetet një nga detyrat më të rëndësishme të Zyrës së Komisionerit, përpos aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe promovuese me qëllim zbatimin sa më efektiv të tij.
Nisur nga rregullimi i kursyer i Ligjit mbi mbikëqyrjen në tërësi, ushtrimi i kësaj kompetence do të kryehet në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, jurisprudencën e gjykatave vendase si dhe aktet e aktet e brendshme të Zyrës së Komisionerit *(urdhëra, rregullore e brendshme, plan vjetor pune, metodologjinë e miratuar*[23]*, praktikën e konsoliduar institucionale).*

[23] Përzgjedhja e organeve apo sipërmarrjeve objekt i mbikqyrjes do të kryhet bazuar në një metologji dhe kritere objektive dhe transparente, duke përfshirë një sistem pikëzimi.

Nisur nga veçoritë e procesit të mbikëqyrjes në kontekstin e këtij Ligji, si dhe faktin që në themel të tij qëndron zbatimi i një *qasje proaktive* të publikimit të të dhënave të hapura dhe jo ndëshkimi i organeve apo sipërmarrjeve, ai do të shtrihet në disa faza. Këto faza do të zbatohen në mënyrë të përshkallzuar/progresive dhe në përputhje me parimet e përgjithshme të të drejtës administrative (nenet 9-20 të Kodit të Procedurës Administrative).



Faza e parë: Mbikëqyrja online

Monitorimi online nga Zyra e Komisionerit do të kryhet në mënyrë periodike dhe ka karakter të vazhdueshëm për shkak të natyrës dinamike të të dhënave të hapura dhe publikimit të tyre. Në

qendër të aktivitetit të mbikëqyrjes janë publikimet proaktive të të dhënave të hapura në faqet zyrtare të internetit të çdo organi të sektorit publik apo sipërmarrje publike apo edhe portalit zyrtar opendata.gov.al.

Në kuadër të veprimtarisë mbikëqyrëse, struktura përkatëse pranë Zyrës së Komisionerit do të mbledhë të dhëna duke vlerësuar plotësimin/përputhshmërinë me:

(i) **Aspektet teknike**: formate të hapura, *machine-readable* si dhe të përputhshme me standardet;

(ii) **Aspektet ligjore**: përdorim pa kushte, por mund të ketë kushte objektive, proporcionale, jo diskriminuese, dhe të justifikuara për shkaqe objektive të interestit publik.

Tabela më poshtë ilustron hapat që do të ndiqen nga stafi mbikëqyrës i Zyrës së Komisionerit.

Kështu gjatë monitorimit online do të vlerësohet nëse nga organi i sektorit publik/sipërmarrja publike janë përmbushur detyrimet si më poshtë:

- ✓ *Krijimi i rubrikës "Open data" në faqen e parë/kryesore të faqes zyrtare të internetit të organit të sektorit publik/sipërmarrjes publike.*

Me qëllim lehtësimin e gjetjes së të dhënave të hapura, organet e sektorit publik/sipërmarrjet publike në faqen e tyre zyrtare krijojnë një rubrikë të dedikuar, titulluar opendata/të dhëna të hapura, ku duhet të publikojnë dokumentet/të dhënat e hapura të tyre.

- ✓ *Publikimi i "Listës së dokumenteve që mund të ofrohen në formatin e të dhënave të hapura", sipas parashikimeve në ligj;*

Lista e dokumenteve që mund të ofrohen në formatin e të dhënave të hapura është një detyrim i vendosur në ligjin nr.33/2022, neni 7 pika 3. Në këtë listë, organi i sektorit publik/sipërmarrja publike përfshin dokumentet/të dhënat që prodhojnë në kuadër të detyrës publike apo shërbimeve që ato ofrojnë.

- ✓ *Verifikimi nëse të dhënat/dokumentet e publikuara janë në formatet e hapura, të rekomanduara (machine readable);*

Dokumentet të cilat përfshihen në listën e sipërcituar mund të gjenden të publikuara në rubrika të ndryshme të faqes zyrtare të çdo institucioni, por jo gjithmonë janë në formate të hapura. Për këtë arsye strukturat përgjegjëse të çdo institucioni do të duhet ti përpunojnë ato në formate të hapura "machine readable" (këto formate janë sqaruar më lart në këtë komentar) dhe duhen publikuar në rubrikën e dedikuar për të dhënat e hapura (opendata/të dhëna të hapura).

✓ *Publikimi i "Licencës standarde";*

Një nga detyrimet e ligjit nr. 33/2022 është aplikimi i "Licencës standarde" e cila përcakton kushtet e ripërdorimit (të drejtat dhe detyrimet e ripërdorimit). Licenca është në formatin elektronik dhe është miratuar me udhëzimin nr. 2, date 6.2.2025 "*Për miratimin e licencës standarde të ripërdorimit të informacionit të sektorit publik*". Organet e sektorit publik/sipërmarrjet publike në faqen e tyre zyrtare, në rubrikën e dedikuar (titulluar opendata/të dhëna të hapura), ku kanë publikuar listën e dokumenteve që mund të ofrohen në formatin e të dhënave të hapura, do të përfshijnë edhe logon e licencës standarde të miratuar.

✓ *Publikimi i tarifave të miratuara, nëse të dhënat e hapura ofrohen kundrejt pagesës, sipas përcaktimeve në ligjin nr.33/2022;*

Ligji nr.33/2022 në nenin 10 parashikon se "*Ripërdorimi i dokumenteve, si rregull, ofrohet pa pagesë".* Po ashtu ligji parashikon edhe përjashtimet nga ofrimi i dokumenteve pa pagesë, si më poshtë:

a) organet e sektorit publik, të cilat, sipas legjislacionit të posaçëm për funksionimin e tyre, sigurojnë të ardhura për të mbuluar një pjesë të konsiderueshme të kostove që lidhen me kryerjen e detyrave të tyre publike;

b) bibliotekat, përfshirë bibliotekat universitare, muzetë dhe arkivat;

c) sipërmarrjet publike.

Në këto raste, tarifat duhet të miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe duhet të publikohen në faqen e vet të internetit, si dhe në portalin unik qeveritar të të dhënave të hapura.

✓ *Nëse të dhënat janë publikuar edhe në portalin opendata.gov.al*

Ligji nr. 33/2022, me qëllim lehtësimin e kërkimit të të dhënave të hapura të ofruara nga organet e sektorit publik, ka parashikuar krijimin/funksionimin e portalit të të dhënave të hapura qeveritare. Organet e sektorit publik/sipërmarrjet publike do të kujdesen që të dhënat e hapura të publikuara në faqet e tyre zyrtare, të publikohen njëkohësisht edhe në portalin unik opendata.gov.al
Ky proces do të bëhet në bashkëpunim me AKSHI-n, si institucioni i cili administron këtë portal. Brenda secilit hap do të evidentohen elementet përkatës, në funksion të vlerësimit objektiv të kërkesave ligjore. Vlerësimi i listës së dokumenteve është element thelbësor i vlerësimit tërësor.

Shembull nga praktika e ndjekur në Malin e ZI:

Në kundër të mbikqyrjes online, organi ose sipërmarrja vlerësohen nëpërmjet një sistemi pikëzimi, bazuar në metodologjinë e miratuar nga organi kompetent.

- *0 pikë (nuk është publikuar apo nuk është e kënaqshme),*
- *0.5 pikë (publikuar pjesërisht apo pjesërisht e kenaqshme) ose*
- *1 pikë (publikuar apo e kënaqshme).*

Përveç pikëzimit për publikimin siç u përmend më sipër, pikë të tjera, jepen në lidhje me informacionin që është publikuar, që përfaqëson praktikë të mirë dhe lehtësi për përdorim (pra rubrikë më vehte për open data) dhe lundrimin në tërësi në faqen e internetit. Funksionalitete të tjera që vlerësohen pozitivisht janë motorrët kërkimore të faqes si dhe pozicionimi i hartës së faqes (ëeb map). Në rastin ideal nëse do të plotësohen të gjitha pikët dhe nënpikët, atëhere organi ose sipërmarrja e mbikqyrur do të arrinte 40 pikë.

Kështu nënpikët jepen për këto aspekte:

1) Aspektet teknike

- *nëse raport është publikuar në faqen e internetit, nëse është publikuar në vend të dukshëm apo në një rubrikë të dedikuar që aksesohet direkt nga faqja zyrtare: 1 pikë nëse është publikuar, por nuk është e lehtë për tu gjetur atëhere jepen 0.5 pikë; dhe nëse nuk është publikuar 0 pikë.*
- *nëse raporti është përditësuar, dhe nëse është përditësuar përpara një viti nga data e monitorimit 1 pikë; nëse është më i vjetër se një vit, 0 pikë;*
- *regjistri publik dhe rekordet publike janë të përfshira- 0.5 pikë; nëse nuk përmban të tilla 0 pikë. (por mund të mos zbatohet për të gjithë organet e sektorit publik).*
- *dokumentet financiar (buxhetet, prokurimi publik)- jepet 0.5 pikë nëse janë të përfshirë; nëse nuk ka të tilla jepet 0 pikë (informacioni për prokurimin publik mund të mos jetë e zbatueshme për të gjitha organet e sektorit publik).*

2) Regjistrat publik dhe rekordet/të dhënat publike

- *nëse regjistri publik është i përshtatshëm për ripërdorim në faqen zyrtare të organit, të gjithë regjistrat: 1 pikë; publikuar vetëm disa regjistrat: 0.5 pikë; asnjë regjistër i publikuar 0 pikë.*
- *nëse regjistri publik është publikuar në format të lexueshëm nga kompiuteri dhe format të hapur, me metadata në format open data: 1 pikë; publikuar në format të mbyllur 0.5 pikë.*
- *nëse regjistrat publik janë publikuar në portalin open data të Malit të Zi: 0.5 pikë; nëse nuk janë publikuar 0 pikë.*

3) Programet e punës dhe planet

- *nëse programet/planet e punës janë publikuar: 1 pikë; nëse nuk janë publikuar 0 pikë.*
- *nëse në arkivën e këtyre dokumenteve gjenden të paktën 3 vitet e fundit: 0.5 pikë; nëse nuk janë publikuar 0 pikë.*

4) Raporte dhe dokumente të tjera mbi punën dhe ecurinë në ushtrimin e kompetencave sipas fushës së organit

- *nëse raport dhe dokumentet e tjera janë publikuar: nëse po, 1 pikë; nëse nuk janë publikuar 0 pikë.*
- *nëse në arkivën e këtyre dokumenteve gjenden të paktën 3 vitet e fundit: 0.5 pikë; nëse nuk janë publikuar 0 pikë.*

5) Projektakte, propozime dhe tekstet përfundimtare të dokumenteve strategjikë, planeve dhe programeve për zbatimin e tyre (jo e zbatueshme për të gjitha organet/sipërmarrjet)

- *nëse projektaktet dhe propozimet për dokumentet strategjikë janë publikuar: nëse po 1 pikë; nëse janë vetëm draftet e publikuar: 0.5 pikë; nëse janë vetëm propozimet: 0.5 pikë; nëse nuk ka as drafte dhe as propozime: 0 pikë.*
- *nëse teksti final i dokumenteve strategjik është publikuar: 1 pikë; nëse nuk është publikuar 0 pikë.*
- *nëse ka një plan apo program për zbatimin e dokumentit strategjik që është publikuar: 1 pikë; nëse nuk është publikuar o pikë.*
- *nëse draftet dhe propozimet e ligjeve dhe rregulloreve të tjera janë publikuar: 1 pikë; vetëm draftet e publikuara 0.5 pikë; vetëm propozimet e publikuara: 0.5 pikë; as drafti dhe as propozimet të publikuara: 0 pikë.*
- *nëse opinioni i ekspertëve është publikuar: 0.5 pikë; nuk është publikuar 0 pikë.*
- *nëse teksti përfundimtar i ligjit apo rregulloreve është publikuar: 1 pikë; nuk është publikuar 0 pikë.*

7) Akte individuale dhe marrëveshje në lidhje me përdorimin e fondeve dhe të ardhurave buxhetore dhe pronës së shtetit

7.1) Dokumentet financiar

- *nëse plani financiar apo buxheti vjetor është publikuar: 1 pikë; nuk është publikuar 0 pikë.*
- *nëse buxheti apo dokumente të tjerë të planifikimit financiar për vitin përkatës janë publikuar: 1 pikë; nuk është publikuar 0 pikë.*
- *nëse buxheti përfundimtar i shpenzuar është publikuar: 1 pikë; nuk është publikuar 0 pikë.*
- *nëse raporti vjetor financiar është publikuar: 1 pikë; nuk është publikuar 0 pikë.*
- *nëse buxheti dhe buxheti përfundimtar i shpenzuar janë publikuar për 3 vitet e fundit: 0.5 pikë; nëse nuk është publikuar 0 pikë.*
- *nëse të dhënat e tabuluara (buxhet dhe raport financiar) janë publikuar në format të lexueshëm nga kompiuteri: 0.5 pikë; nëse nuk është publikuar 0 pikë.*

7.2) Prokurimi publik (nëse është e zbatueshme për organet që janë subjekt i ligjit për prokurimin publik)

- *nëse ka një plan për prokurimet publike të publikuar (kjo vlen edhe për prokurimet më vlerë të vogël): 1 pikë; nëse nuk është i publikuar 0 pikë.*

- *nëse raporti i prokurimit publik është publikuar: 1 pikë; nuk është publikuar 0 pikë.*
- *nëse kontratat e prokurimit publik janë publikuar: 1 pikë; nuk është publikuar 0 pikë.*
- *nëse informacioni mbi prokurimin publik është i publikuar edhe për vitet e kaluara: o,5 pikë; nëse nuk është i publikuar 0 pikë.*

Në përfundim të këtij procesi, struktura përgjegjëse përgatit një raport përmbledhës mbi gjetjet dhe problematikat e konstatuara që kanë rezultuar gjatë mbikqyrjes dhe ja paraqet Drejtorit të Përgjithshëm pranë Drejtorisë për të Drejtën e Informimit.

Drejtori i Përgjithshëm analizon gjetjet përkatëse nga mbikëqyrja e faqeve dhe bazuar në këto gjetje, bën rekomandimet tek Komisioneri lidhur me vijimësinë e procesit si më poshtë:

- *rekomandim mbi përmbushjen/përmirësimin e zbatimit të detyrimeve të Ligjit nr. 33/2022;*

ose,

- *nëse situata paraqitet me mangësi të theksuara dhe informacioni nuk është përditësuar prej një periudhe të gjatë kohore, mund të rekomandohet mbikëqyrje në terren pranë organit të sektorit publik/sipërmarrjes publike.*

Bazuar në këtë rekomandim, Komisioneri në përputhje me kompetencat e parashikuara në nenin 18 dhe 19 të Ligjit, vendos vijimin e procedurës me:

- *nxjerjen e rekomandimit;*
  ose
- *kryerjen e mbikqyrjes në terren*.

Në rastin e dhënies së rekomandimeve, Komisioneri ndër të tjera, përcakton edhe një afat të arsyeshëm brenda të cilit organet e sektorit publik apo sipërmarrjet publike, duhet të marrin masa

për adresimin e çështjeve të identifikuara. Në vijim, struktura përgjegjëse pranë Zyrës së Komisionerit mbikëqyr ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna. Nëse në përfundim të afatit të caktuar, organi i sektorit publik apo sipërmarrja publike nuk ka marrë ende asnjë masë konkrete për përmbushjen e rekomandimit apo ka plotësuar pjesërisht rekomandimet, Komisioneri shqyrton mundësinë e veprimeve të tjera procedurale në përputhje me parashikimet e nenit 18 të ligjit nr.33/2022, ku përfshihen:

- *konstatimi i mospërmbushjes së rekomandimit/eve pas tejkalimit të afatit;*
- *njoftimi për kryerjen e mbikqyrjes në terren, brenda një afati të arsyeshëm.*

Faza e dytë: Mbikëqyrja në terren pranë selisë së organit të sektorit publik apo sipërmarrjes publike

Mbikëqyrja në terren, përbën një masë progresive që në vetvete synon të shtyjë/nxisë organin apo sipërmarrjen drejt publikimit të të dhënave të hapura. Objektivi kryesor i mbikqyrjes në terren, është të orientojë/ndërgjegjësojë organin e sektorit publik apo sipërmarrjen publike, mbi kuptimin dhe zbatimin e drejtë të detyrimeve të ligjit.

Nga pikëpamja procedurale, nëpërmjet urdhrit të miratuar të Komisionerit, organi i sektorit publik apo sipërmarrja publike informohet paraprakisht për mbikëqyrjen në terren. Në këtë urdhër, ndër të tjera, përcaktohet grupi i punës, afati brenda të cilit do të kryhet mbikëqyrja dhe gjetjet apo problematikat e konstatuara nga mbikëqyrja online e kryer më herët. Në vijim, grupi i punës paraqitet pranë organit të sektorit publik/sipërmarrjes publike dhe kontakton personin(at) e autorizuar për të përfaqësuar organin në këtë proces. I gjithë procesi i mbikëqyrjes dokumentohet në procesverbal, i cili mbahet midis grupit të punës dhe përfaqësuesve të organit të sektorit publik apo sipërmarrjes publike.

Në përfundim të mbikëqyrjes, nëse konstatohet disponueshmëria e organit të sektorit publik apo sipërmarrjes publike për të marrë masa për përmbushjen e mangësive të konstatuara, përfaqësuesit e Zyrës së Komisionerit i japin organit të sektorit publik kohën e nevojshme. Pas kalimit të këtij afati, struktura përgjegjëse kryen sërisht mbikëqyrje online të faqes zyrtare për të verifikuar nëse janë plotësuar mangësitë e konstatuara.

Faza e tretë: Dhënia e masës administrative

Nëse konstatohet se organi i sektorit publik apo sipërmarrja publike edhe pas kryerjes së mbikëqyrjes online dhe në terren, nuk ka plotësuar rekomandimet pa shkak të arsyeshëm, grupi i punës reflekton në relacion gjetjet, procedurën e ndjekur dhe mbyll procedurën e mbikqyrjes. Në këto kushte, Komisioneri merr vendim për vendosjen e masave administrative në përputhje me parashikimet e nenit 18 të Ligjit nr.33/2022. Ligji parashikon masat e mëposhtme si:

a) refuzimi i vënies në dispozicion të dokumenteve për ripërdorim në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji dënohet me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë;
b) mospublikimi i tarifave në kundërshtim me pikën 5 të nenit 10 të këtij ligji dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë;
c) mosrespektimi i kërkesave ligjore për kushtet e ripërdorimit/licencës standarde dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë;
d) mospublikimi i listës së dokumenteve ekzistuese që mund të ofrohen në formatin e të dhënave të hapura dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë;

e) mosbashkëpunimi dhe mosdhënia e informacionit të kërkuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për përmbushjen e detyrave të përcaktuara në këtë ligj dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

Ligji parashikon që vendosja e masave administrative ndaj organit të sektorit publik ose sipërmarrjes publike që kryen kundërvajtje administrative duhet të jetë proporcionale me dëmin dhe shkeljet e shkaktuara. Komisioneri gëzon diskrecion në vendosjen e masës duke patur parasysh të gjitha rrethanat dhe specifikat e çështjes.

Në çdo rast, organi i sektorit publik ose sipërmarrja publike brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit mund të bëjë ankim në gjykatë në përputhje me ligjin për kundërvajtjet administrative.

ANEKSET

ANEKSI 1 – LISTA E ORGANEVE TË SEKTORIT PUBLIK

NR	Organet e Sektorit Publik
1	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
2	Agjencia e Auditit të Programeve të Asistencës së Akredituar nga BE
3	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
4	Agjencia e Prokurimit Publik - APP
5	Agjencia e Shërbimeve të Sportit
6	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar - ASCAP
7	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë ASCAL
8	Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD)
9	Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO)
10	Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera
11	Agjencia e Trajtimit të Pronave - ATP
12	Agjencia Kombëtare Bërthamore
13	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
14	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore - AKBPM
15	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
16	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)
17	Agjencia Kombëtare e Diasporës
18	Agjencia Kombëtare e Falimentit
19	Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë - AKFAL
20	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit
21	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
22	Agjencia Kombëtare e Mjedisit - AKM
23	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit AKPT
24	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive - AKPA
25	Agjencia Kombëtare e Pyjeve
26	Agjencia Kombëtare e Rinisë
27	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit - AKSHI
28	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar - AKSIK
29	Agjencia Kombëtare e Turizmit
30	Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve
31	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
32	Agjencia për Eficiencën e Energjisë

33	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile - AMSHC
34	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
35	Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural
36	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve AIDA
37	Agjencia Shtetërore e Kadastrës - ASHK
38	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
39	Agjencia Shtetërore për Shpronësimin
40	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës - ASHDMF
41	Agjencia Telegrafike Shqiptare - ATSH
42	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror
43	Akademia e Shkencave e Shqipërisë
44	"Albgaz" Sh.a
45	"Albpetrol" Sh.a. Fier
46	Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit
47	Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor
48	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor - ASIG
49	Autoriteti i Aviacionit Civil
50	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)
51	Autoriteti i Konkurrencës
52	Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE)
53	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)
54	Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojrave të Fatit - AMLF
55	Autoriteti i Mediave Audiovizive - AMA
56	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)
57	Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike - AKCESK
58	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencën në Miniera -AKSEM
59	Autoriteti për Informacionin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit
60	Autoriteti Portual Durrës
61	Autoriteti Rrugor Shqiptar - ARRSH
62	Avokati i Popullit
63	Avokatura e Shtetit
64	Banka e Shqipërisë - BSH
65	Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë
66	Bordi i Mbikëqyrjes Publike
67	Byroja Kombëtare e Hetimit - BKH
68	Departamenti i Administratës Publike - DAP
69	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas

70	Drejtoria e Përgjithshme Detare
71	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit
72	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave
73	Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar - AKAP
74	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
75	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
76	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë
77	Agjencia e Inteligjences Financiare
78	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
79	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale
80	Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit
81	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor - DPSHTRR
82	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor
83	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
84	Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit
85	Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë
86	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve - DPT
87	Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare
88	Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik - DSHTD
89	Autoriteti Kombëtar i Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar
90	Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor - OSHKSH
91	Enti Kombëtar i Banesave
92	Enti Rregullator i Energjisë - ERE
93	Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit të Përpunimit të Ujërave të Ndotur
94	Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve
95	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor - FSDKSH
96	Fondi Shqiptar i Zhvillimit - FSHZH
97	Garda e Republikës së Shqipërisë
98	Illyrian Guard Sh.a
99	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave - ILDKPKI
100	Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit - IKMT
101	Inspektorati Qendror
102	Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut - ISHMT
103	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
104	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor - ISHSH
105	Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial - ISHTI

106	Inspektori i Lartë i Drejtësisë - ILD
107	Instituti i Integrimit të të Përndjekurve Politikë
108	Instituti i Mjekësisë Ligjore
109	Instituti i Ndërtimit
110	Instituti i Shëndeti Publik - ISHP
111	Instituti i Sigurimeve Shoqërore - ISSH
112	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë - ISUV
113	Instituti i Statistikave - INSTAT
114	Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri
115	Instituti i Transportit
116	Këshilli i Lartë Gjyqësor - KLGJ
117	Këshilli i Lartë i Prokurorisë - KLP
118	Këshilli i Qarkut Berat
119	Këshilli i Qarkut Dibër
120	Këshilli i Qarkut Durrës
121	Këshilli i Qarkut Elbasan
122	Këshilli i Qarkut Fier
123	Këshilli i Qarkut Gjirokastër
124	Këshilli i Qarkut Korçë
125	Këshilli i Qarkut Kukës
126	Këshilli i Qarkut Lezhë
127	Këshilli i Qarkut Shkodër
128	Këshilli i Qarkut Tiranë
129	Këshilli i Qarkut Vlorë
130	Kolegji i Posaçëm i Apelimit - KPA
131	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil - KMSHC
132	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi - KMD
133	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale - KDIMDP
134	Komisioni i Prokurimit Publik - KPP
135	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve - KQZ
136	Komiteti për Pakicat Kombëtare
137	Komitet Shqiptar i Birësimeve - KSHB
138	Komiteti Shtetëror për Kultet
139	Kontrolli i Lartë i Shtetit - KLSH
140	Kryeministria
141	Kuvendi i Republikës së Shqipërisë
142	Ministria e Arsimit dhe Sportit - MAS

143	Ministria e Brendshme - MB
144	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural - MBZHR
145	Ministria e Drejtësisë - MD
146	Ministria e Financave
147	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë - MIE
148	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit - MEKI
149	Ministria e Mbrojtjes - MM
150	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - MSHMS
151	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit - MTM
152	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme - MEPJ
153	Prefekti i Qarkut Berat
154	Prefekti i Qarkut Dibër
155	Prefekti i Qarkut Durrës
156	Prefekti i Qarkut Elbasan
157	Prefekti i Qarkut Fier
158	Prefekti i Qarkut Gjirokastër
159	Prefekti i Qarkut Korçë
160	Prefekti i Qarkut Kukës
161	Prefekti i Qarkut Lezhë
162	Prefekti i Qarkut Shkodër
163	Prefekti i Qarkut Tiranë
164	Prefekti i Qarkut Vlorë
165	Presidenti i Republikës së Shqipërisë
166	Prokuroria e Përgjithshme
167	Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar - SPAK
168	Qendra e Botimeve për Diasporën - QBD
169	Qendra e Botimeve Zyrtare - QBZ
170	Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm
171	Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut të Forcave të Armatosura
172	Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve
173	Qendra e Pritjes për Azil
174	Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit
175	Qendra e Shërbimeve Arsimore - QSHA
176	Qendren e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore
177	Qendra Kombëtare e Biznesit - QKB
178	Qendra Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore
179	Qendra Kombëtare e Kinematografisë

180	Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut
181	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore
182	Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët
183	Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare - QNOD
184	Qendra Ndërinstitucionale Rrjeti Akademik Shqiptar - RASH
185	Rezidenca Studentore Universitare Sh.a
186	Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse - EITI
187	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
188	Shërbimi Informativ i Shtetit - SHISH
189	Shërbimi Social Shtetëror
190	Shkolla e Magjistraturës
191	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
192	Shoqëritë Huamarrëse në Administrim
193	Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura
194	Urdhri i Farmacistëve
195	Urdhri i Infermierit
196	Urdhri i Mjekut
197	Urdhri i Psikologut
198	Urdhri i Stomatologut
199	Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parqeve Arkeologjike Apoloni dhe Bylis
200	Zyra e Koordinimit të Parkut të Butrintit
201	Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
202	Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A
203	Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje
204	Autoriteti i Investigimit të Incidenteve dhe Aksidenteve Hekurudhore e Detare
205	Autoriteti për Sigurinë Hekurudhore
206	Autoritetit Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve - AKVMB
207	"IdentiTek" Sh.a
208	Agjencia Kombetare e Kontrollit te Cannabis-it
209	Korporata e Investimeve Shqiptare sh.a
210	Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil
211	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat
212	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër
213	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës
214	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan
215	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier
216	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër

217	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë
218	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës
219	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë
220	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë
221	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër
222	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë
223	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë
224	Prokuroria e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm
225	Gjykata Administrative e Apelit
226	Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm
227	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë
228	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnje
229	Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
230	Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
231	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat
232	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër
233	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës
234	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan
235	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier
236	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër
237	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë
238	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës
239	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë
240	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë
241	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër
242	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë
243	Agjencia e Zhvillimit të Territorit – AZHT
244	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë
245	Gjykata e Lartë
246	Gjykata Kushtetuese
247	Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës
248	Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Start-up-ve dhe Lehtësuese
249	Agjencia për Media e Informim
250	Bashkia Belsh
251	Bashkia Berat
252	Bashkia Bulqizë
253	Bashkia Cërrik

254	Bashkia Delvinë
255	Bashkia Devoll
256	Bashkia Dibër
257	Bashkia Dimal
258	Bashkia Divjakë
259	Bashkia Dropull
260	Bashkia Durrës
261	Bashkia Elbasan
262	Bashkia Fier
263	Bashkia Finiq
264	Bashkia Fushë-Arrëz
265	Bashkia Gjirokastër
266	Bashkia Gramsh
267	Bashkia Has
268	Bashkia Himarë
269	Bashkia Kamëz
270	Bashkia Kavajë
271	Bashkia Këlcyrë
272	Bashkia Klos
273	Bashkia Kolonjë
274	Bashkia Konispol
275	Bashkia Korçë
276	Bashkia Krujë
277	Bashkia Kuçovë
278	Bashkia Kukës
279	Bashkia Kurbin
280	Bashkia Lezhë
281	Bashkia Libohovë
282	Bashkia Librazhd
283	Bashkia Lushnje
284	Bashkia Malësi e Madhe
285	Bashkia Maliq
286	Bashkia Mallakastër
287	Bashkia Mat
288	Bashkia Memaliaj
289	Bashkia Mirditë
290	Bashkia Patos

291	Bashkia Peqin
292	Bashkia Përmet
293	Bashkia Pogradec
294	Bashkia Poliçan
295	Bashkia Prrenjas
296	Bashkia Pukë
297	Bashkia Pustec
298	Bashkia Roskovec
299	Bashkia Rrogozhinë
300	Bashkia Sarandë
301	Bashkia Selenicë
302	Bashkia Shijak
303	Bashkia Shkodër
304	Bashkia Skrapar (Çorovodë)
305	Bashkia Tepelenë
306	Bashkia Tiranë
307	Bashkia Tropojë
308	Bashkia Vau i Dejës
309	Bashkia Vlorë
310	Bashkia Vorë

ANEKSI 2 – LISTA E SIPËRMARRJEVE PUBLIKE

Nr.	Sipërmarrjet Publike
1	Hekurudha Shqiptare Sh.a
2	"Albcontrol" - Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror (ANTA)
3	KESH Sh.a, Tiranë
4	OSHEE sh.a
5	Operatori i Sistemit të Transmetimit - OST Sh.a
6	Porti Detar Sarandë Sh.a
7	Porti Detar Shëngjin Sh.a
8	Porti Detar Vlorë Sh.a
9	Posta Shqiptare Sh.a
10	Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a
11	Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Gjirokaster Sh.A
12	Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Durres Sh.A
13	Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Elbasan Sh.A
14	Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Lushnje Sh.A
15	Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Kukes Sh.A
16	Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Fier Sh.A
17	Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Vlore Sh.A
18	Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Lezhe Sh.A
19	Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Shkoder Sh.A
20	Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Korce Sh.A
21	Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Diber Sh.A
22	Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec Sh.A
23	Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Berat Sh.A
24	Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Sarande Sh.A

ANEKSI 3: FORMATI PËR PARAQITJEN E KËRKESËS PËR RIPËRDORIM PRANË ORGANIT TË SEKTORIT PUBLIK DHE SIPËRMARRJES PUBLIKE

FORMULAR KËRKESE PËR RIPËRDORIMIN E INFORMACIONIT TË KRIJUAR NGA [EMRI I ORGANIT/SIPËRMARRJES PUBLIKE] **Në bazë të Ligjit Nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik"**	
Emri i kërkuesit:	
Mbiemri i kërkuesit:	
Subjekti juridik (nëse aplikohet):	
Adresa:	
Qyteti:	
Numri i telefonit:	
Email:	
Përcaktoni çfarë informacioni dëshironi për ripërdorim (listoni sa më shumë detaje për të kuptuar arsyen e përdorimit):	
Përcaktoni se si do ta përdorni informacionin (për shembull për publikim tregtar, për të zhvilluar një produkt apo shërbim etj.):	
Nëse planifikoni të publikoni informacionin, ju lutem jepni informacion mbi titullin e publikimit, faqen e internetit, emrin e publikuesit etj.	
Emër, Mbiemër, Firma *Data:* Dërgoni formularin e plotësuar në adresën [info]@[emri i organit/sipërmarrjes]/me postë	

ANEKSI 4: FORMATI PËR PARAQITJEN E ANKESËS PËR RIPËRDORIM PRANË ORGANIT TË SEKTORIT PUBLIK DHE SIPËRMARRJEVE PUBLIKE

FORMULAR ANKESE

Drejtuar
Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Në bazë të Ligjit Nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik"

Emri / Mbiemri[24] :
Adresa:
Qyteti :
Telefon:
E-mail:

Organi i Sektorit Publik/ Sipërmarrja Publike:
Adresa:
Qyteti:

Identifikoni saktë Organi i Sektorit Publik /Sipërmarrja Publike ndaj të cilit ankoheni.

Përshkruani çdo veprim të pretenduar si shkelje nga Organi i Sektorit Publik/Sipërmarrja Publike dhe nëse dispononi dokumente bashkëlidhini ato.

_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____

Përshkruani çfarë kërkoni nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me nenin 20 të ligjit nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik"

_____
_____
_____
_____
_____

[24] Në rastet kur informacioni i kërkuar përmban të dhëna personale, kërkohet dokumenti i identifikimit të kërkuesit.

(Data) _____

(Firma) _____

Formulari i ankesës duhet të shoqërohet me formularin e kërkesës për ripërdorim drejtuar Organit të Sektorit Publik/Sipërmarrjes Publike si dhe recetën postare ose emailin drejtuar tyre.

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me legjislacionin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Për sqarime më të detajuara kontaktoni KDIMDP në emailin info@idp.al dhe nr.tel: +355 42 23 7200.